

ME
PARA EVROPIANE
DERI TE ZHVILLIMI I
TURIZMIT
ALTERNATIV



**ME PARA EVROPIANE DERI TE ZHVILLIMI I
TURIZMIT ALTERNATIV**

Me para evropiane deri te zhvillimi i turizmit alternativ

Boton:

Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni

Për botuesin:

Vladimir Milçin, Drejtor ekzekutiv

Autor:

Qendra maqedonase për arsim evropian

Përkthim:

Abakus

Formësimi grafik:

Brigada dizajn

Shtyp:

Propoint

Tirazhi:

500 ekzemplarë

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека
“Св. Климент Охридски”, Скопје

338.48-6:379.845(497.7)

338.48-6:502/504(497.7)

ME para evropiane deri te zhvillimi i turizmit alternativ. - Shkup :
Fondacioni instituti shoqëria e hapur - Maqedoni, 2010. -
60 стр. : илустр. ; 20 см

Превод на делото: Со европски пари до развој на
алтернативниот туризам

ISBN 978-608-218-069-4

a) Алтернативен туризам - Можности - Македонија
COBISS.MK- ID 83181834

**ME PARA EVROPIANE DERI TE ZHVILLIMI I
TURIZMIT ALTERNATIV**

Përmbajtje

1. HYRJE	05
2. POLITIKA PËR ZHVILLIM RURAL PERIUDHA 2007-2013	07
2.1 Rregullativa me të cilat rregullohet politika për zhvillim rural	09
3. TURIZMI NË BE	11
3.1 Zhvillimi i politikave për turizëm	13
3.2 Politika për turizmin në BE	16
3.3 Programe dhe iniciativa që janë aktuale në BE	17
4. PROJEKTE QË KANË SHFRYTËZUAR PARA EVROPIANE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT ALTERNATIV	21
5. INSTRUMENTE FINANSIARE TË BE NË LËMIN E TURIZMIT	45
6. INSTRUMENTET FINANSIARE TË BE QË I QËNDROJNË NË PDISPOZICION MAQEDONISË	51
6.1 IPARD	51
6.2 IPA BASHKËPUNIMI TEJKUFITAR	58



HYRJE

Dëshira për ikje nga industrializimi dhe rendi tejet i madh në përditshmërinë kontribuojnë që njerëzit gjithnjë e më tepër ta zgjedhin turizmin alternativ si mënyrë të pushimit në kohën e sotme. Kthyerja kah natyra, afrimi ndaj traditës dhe rrënjëve të veta janë kënaqësi të cilat turisti bashkëkohor gjithnjë e më tepër i kërkon. Gjatë rreth 10 viteve të kaluara një numër i madh i vendeve-anëtare të BE përmes programeve të ndryshme dhe me përkrahjen nga fondet evropiane e shfrytëzuan mundësinë për zhvillimin e segmenteve të ndryshme të turizmit alternativ.

Qëllimi i kësaj broshure është ti prezantojmë mundësitë që i ofrojnë programet e BE dhe ti zgjerojmë horizontet për promovimin e këtij lloji turizmi tek ne. Storjet dhe përvojat e ndryshme të suksesshme nga shtetet evropiane të cilat i prezantojmë në këtë broshurë, janë vetëm një pjesë e vogël nga projektet e shumta të suksesshëm që janë realizuar në praktikë. Do t'ju rrëfejme storje të ndryshme, do t'ju themi diçka për bashkëpunimin midis shteteve dhe regjioneve, do t'ju prezantojmë projekte në kuadër të një shteti ose të një regjioni, projekti qëllimi i të cilave për-

fundimtar është zhvillimi i sferës së caktuar nga turizmi, ngritje e vetëdijes për ambientin, përmirësimi i gjendjes ekonomike dhe rritje e numrit të vendeve të punës.

Prapëseprapë, qëllimi më i rëndësishëm është njohja e subjekteve që janë të kyçur në turizmin në Republikën e Maqedonisë me mundësitë të cilat i ofron Bashkimi Evropian



Midis tjerash, Maqedonia është përplot me një numër të madh të përmendoreve kulturo-historike, banja, parqe kombëtare dhe parqe të natyrës të cilat mund të shfrytëzohen para evropiane, ta shtojnë numrin e vendeve të punës dhe të kontribuojnë për zhvillimin e regionit.



pian përmes fondeve të saja, si dhe zhvillimi i këtij sektori me perspektivë tek ne.

Një pjesë e madhe nga projektet që janë prezantuar janë të aplikueshëm edhe në Maqedoni. Maqedonia, në të vërtetë, ka kushte të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit çiklistik, kulturor, eko-turizmin dhe turizmin në fshata turizmin speleologjik e kështu me radhë.

Rajonet në Vevčan, Brajçino, Konjsko, Berovë dhe shumë të tjera janë vetëm një pjesë e vogël e rajoneve të shumta për zhvillimin e ekoturizmit dhe turizmit fshatar. Maqedonia mund të ofrojë edhe vise të shkëlqyera për turizëm çiklistik malor në Malin Shar, Mavrovë, Galiçicë, Vodno e kështu me radhë. Shpellat Vrello, Peshna, Ubava Sharkova Dupka, Alilica, Slatinska Peshtera dhe të tjera ofrojnë mundësi për turizmin shpellor dhe të turizmit rekreativ.



POLITIKA PËR ZHVILLIM RURAL PERIUDHA 2007-2013

Zhvillimi rural është lëmi e cila kyç nën lëmi të ndryshme, midis të cilave edhe turizmin, që është lëndë e kësaj broshure. Për këtë shkak, konsideronim se është e nevojshme ta prezantojmë zhvillimin rural si lëmi e cila e përfshin turizmin dhe përmban materie të vendosur në rregullativa, për dallim nga turizmi rregullimi i të cilit në kuadër të Unionit ende është në zanafillë.

Mbi 56% nga popullata në 27 vendet anëtare të BE e cila jeton në rajonet rurale dhe mbulon rreth 91% të territorit, zhvillimi rural është lëmi me rëndësi jetike.

Përgjithësisht, të ardhurat mesatare për kokë banori janë më të ulëta në regionet rurale, krahasuar me qytetet dhe fshatrat, por numri i shkathtësive

është më i vogël, ndërsa sektori i shërbimeve është më pak i zhvilluar. Poashtu, kujdesi për zhvillimin rural shpesh herë sjell shpenzime të larta. Nga ana tjetër, hapësira rurale evropiane ka shumëçka të ofrojë. Na jep lëndë të para bazë, ndërsa vlerat si vend për bukuri, pushim dhe rekreacion janë më se të dukshme. Shumë njerëz janë tërhequr nga ideja të jetojnë dhe/ose të punojnë atje nëse ka shërbime dhe infrastrukturë përkatëse. Kjo do të thotë se Strategjia e Lisbonës për hapjen e vendeve të punës dhe për rritje, si dhe Strategjia nga Geteborgu për zhvillim të qëndrueshëm, janë poashtu relevante për mjediset rurale, siç janë relevante për mjediset qytetare.

Politikat e BE për zhvillim rural është e ndërlidhur me ballafaqimin e sfidave me të cilat ballafaqohen rajonet rurale dhe zbulimi i potencialit të tyre.

Pse politikë e përbashkët për zhvillim rural?

Shikuar nga ana teorike, çdo vend-anëtar i BE mund të vendos që në mënyrë të pavarur të sjell dhe të zbatojë politika vetanake për zhvillim rural. Prapëseprapë, qasja e këtillë në praktikë do të funksiononte vështirë. Të gjitha shtetet-anëtare të BE nuk do të mund t'ia lejojnë vetes politikën e cila u nevojitet. Shumë nga problemet që trajtohen përmes politikës për zhvillim rural nuk janë rreptë të kufizuara në kufijtë kombëtar dhe regional, por ndikojnë edhe më larg. Poashtu, politika e BE për zhvillim rural ka shumë pika të përbashkëta me politikat tjera në nivel të BE.

Për këtë shkak, BE ka politikë të përbashkët për zhvillim rural i cili, prapëseprapë, mundëson kontroll të caktuar në duart e vetë vendeve-anëtare dhe të regjioneve. Politika pjesërisht është e financuar nga buxheti qendror i BE, e pjesërisht nga buxhetet kombëtare dhe nga ato regjionale të shteteve-anëtare.

Struktura e politikës së zhvillimit rural

Rregullat kryesore të politikës së zhvillimit rural në periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2013, si dhe masat e politikave publike, janë të përfshira në Rregullativën të Këshillit (KE) nr. 1698/2005. Sipas kësaj Rregullative, politika për zhvillim rural në periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2013 fokusohet në tre lëmi:

- përmirësimi i konkurrencës së sektorit bujqësor dhe pylltar;
- përmirësimi i ambientit dhe i rrethit jetësor; dhe
- përmirësimi i cilësisë së jetës në mjediset rurale dhe inkurajimi i diversifikimit të ekonomisë rurale.

Për të siguruar qasje të balancuar në politikën, shtetet-anëtare dhe regjionet janë të obliguara që ti shpërndajnë financat për zhvillim rural drejt të tria lëmive. Kërkesë plotësuese është që një pjesë e financave të orientohen kah përkrahja e projekteve të cilat mbështeten në përvojat nga iniciativa Lider.

“Qasja Lider” kyç projekte individuale të dizajnuara dhe të zbatuara përmes partneriteteve lokale për zgjidhjen e problemeve specifike lokale.

Edhe para vitit 2007 çdo shtet-anëtar ishte i detyruar të vendos program për zhvillim rural, i cili specifikonte cilat fonde do të shpenzohen në cilat masa në periudhën e viteve 2007–2013.

Karakteristika e re për periudhën 2007–2013 është domethënia më e madhe që i jepet strategjisë koherente për zhvillim rural përmes BE si tërësi. Kjo arrihet përmes përdorimit të planeve të strategjive kombëtare të cilat patjetër duhet të bazohen në udhëzimet strategjike të BE.

2.1. Rregullativa me të cilat rregullohet politika për zhvillim rural

Ne tekstin që vijon janë dhënë një varg rregullativa me të cilat Bashkimi Evropian i rregullon çështjet për përkrahje të sektorit rural, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e ndryshme.

Udhëzime strategjike

- **2006/144/KE: Vendimi i Këshillit i 20 shkurtit të vitit 2006 për Udhëzimet Strategjike të Bashkësisë për zhvillim rural (periudha e viteve 2007–2013)**

Rregullativa

- **Rregullativa e Këshillit (EC) nr. 1698/2005 nga 20 shtatori i vitit 2005 për përkrahjen e zhvillimit rural nga Fondi Evropian bujqësor për zhvillim rural;**
- **Rregullativa e Këshillit (EC) nr. 1944/2006 nga 19 dhjetori i vitit 2006 e cila e ndryshon Rregullativën (EC) nr. 1698/2005;**
- **Rregullativa e Komisionit (KE) nr. 1974/2006 nga 15 dhjetori i vitit 2006 e cila jep udhëzime të detajuara për aplikimin e Rregullativës së Këshillit (EC) nr. 1698/2005 për përkrahjen e zhvillimit rural nga Fondi Evropian bujqësor për zhvillim rural;**
- **Rregullativa e Komisionit (KE) nr. 434/2007 nga 20 prilli i vitit 2007 për ndryshim të Rregullativës së Këshillit (EC) nr.1944/2006 për shkak të aderimit të Bullgarisë dhe të Rumanisë në BE;**





- **Rregullativa e Komisionit (KE) nr. 363/2009 nga 4 maji i vitit 2009**, e cila e ndryshon Rregullativën e Këshillit (EC) nr. 1944/2006;
- **Rregullativa e Komisionit (EK) nr. 1320/2006 nga 5 shtatori i vitit 2006** e cila i vendos rregullat për tranzicion drejt përkrahjes së zhvillimit rural, e siguruar në Rregullativën e Këshillit (EC) nr. 1698/2005;
- **Rregullativa e Këshillit (EC) nr. 1463/2006 nga 19 qershori i vitit 2006** e cila e miraton Rregullativën e Këshillit (EC) nr. 1698/2005 për përkrahje të zhvillimit rural nga Fondi Evropian bujqësor për zhvillim rural për shkak të aderimit të Bullgarisë dhe të Rumanisë në BE;
- **2006/664/EC: Vendimi i Këshillit nga 19 qershori i vitit 2006** e cila e miraton Aneksin VIII nga Akti për aderimin e Bullgarisë dhe Rumanisë.
- **2006/664/EC: Vendimi i Këshillit nga 19 qershori i vitit 2006** e cila e miraton Aneksin VIII nga Akti për aderimin e Bullgarisë dhe Rumanisë. **2006/664/EC: Vendimi i Këshillit nga 19 qershori i vitit 2006** e cila e miraton Aneksin VIII nga Akti për aderimin e Bullgarisë dhe Rumanisë.



TURIZMI NË BE

Turizmi është njëri nga aktivitetet i cili ka potencial më të rëndësishëm për gjenerimin e rritjes dhe punësimit në BE. Poashtu, turizmi kontribuon për zhvillimin dhe integrimin socio-ekonomik në regjionet rurale, periferike ose ato më pak të zhvilluara. Në vitin 2006, turizmi kontribuoi me rreth 5% ndaj bruto-prodhimit vendor të Unionit. Në të ishin të kyçura 1,8 milion kompani, të cilat drejtpërdrejtë punësonin 9,7 milion njerëz, përkatësisht 5,2% nga popullata e aftë për punë. Prapëseprapë

kontributi i tërthortë i turizmit është shumë më i madh: turizmi, bashkë me sektorët tjerë të ndërlidhur, në mënyrë të tërthortë gjeneron më tepër se 10% nga BPV të BE, ndërsa përfshin pothuajse 12% nga numri i tërësishëm të të punësuarve. Shkalla e hapjes së vendeve të reja në turizmin është më i lartë nga mesatarja e ekonomisë evropiane si tërësi. Gjatë decenies së kaluar, shkalla vjetore e punësimit në sektorin e turizmit pothuajse gjithmonë ka qenë më e lartë nga shkalla e punësimit të tërësishëm.


Në statistikën e turizmit ndërkombëtar dhe numrin e turistëve, Bashkimi Evropian vazhdimisht konsiderohet për destinacioni numër 1 në botë, me rreth 380 milion udhëtime ndërkombëtare turistike, që paraqet 42% nga numri i përgjithshëm i udhëtimeve ndërkombëtare turistike në botë në vitin 2007. Të hyrat e gjeneruara nga turistët e huaj në nivel të BE është 75,6 miliard euro në vitin 2007. Bashkimi Evropian, poashtu, është burim i rëndësishëm i turistëve: në vitin 2008 numri i udhëtimeve i realizuar nga banorët e BE, pavarësisht nga destinacioni dhe koha e qëndrimit ka qenë rreth 1,4 miliard udhëtime.

Prapëseprapë, me qëllim që BE ta ruajë pozicionin prijës – si destinacioni turistik numër 1 në botë – turizmi evropian duhet t'ju përshtatet numrit gjithnjë e më të madh të sfidave (për shembull, kapaciteti i ndërmarrjeve evropiane turistike të ndërmarrin inovacione dhe teknologji të reja, konkurrenca ndërkombëtare e cila vazhdimisht rritet e kështu me radhë), me qëllim që të shmanget zvogëlimi i pjesëmarrjes së tregut në raport me regjionet tjera.

Njëloj si edhe sektorët tjera ekonomike, edhe turizmi u prek nga kriza ekonomike, por u dëshmuua se, prapëseprapë, është një nga sektorët i cili është më rezistues ndaj krizës.

Dy hulumtimet e Eurobarometrit për turizmin në vitin 2009 treguan se turistët evropian edhe më tej udhëtojnë, madje edhe pse sjellja e tyre synon drejt asaj që të përshtatet në pajtim me rrethanat. Këtë e konfirmon fakti se në deceniet e fundit turizmi bëhet aspekt gjithnjë e më i rëndësishëm të shprehjeve të qytetarëve të BE. Kështu, në vitin 2008, 53,9% nga banorët e BE (më të moshuar se 15 vjet) së paku një herë kanë udhëtuar me minimum katër bujtje në ose jashtë Evropës.

Edhe parashikimet afatgjata të Organizatës Botërore turistike janë në linjë të rritjes për turizmin në BE. Prapëseprapë, pa marrë parasysh që parashikimet tregojnë se numri absolut i turistëve në BE, parashihet që në përqindje numri i turistëve të bjerë në llogari të numrit të rritur të turistëve në kontinentet tjera, para së gjithash në Azinë Lindore.



3.1 Zhvillimi i politikave për turizëm

Për momentin, BE nuk ka politikë zyrtare për turizëm me rregullativa të cilat e rregullojnë këtë lëmi. Prapëseprapë, gjatë disa viteve të fundit, posaçërisht pas miratimit të strategjisë së re të Lisbonës, BE ka arritur përparim të rëndësishëm në këtë drejtim.

Më 20 tetor të vitit 2005, në forumin e katërt Evropian për turizëm për herë të parë rregullohen politikat e BE në lëmin e turizmit. Në këtë forum në Maltë, Ginter Ferhojgen, kryetari i atëhershëm i Komisionit Evropian përgjegjës për industrinë dhe ndërmarrjet, fillon fjalim i cili menjëherë vitin e ardhshëm shndërrohet në Komunikatë të Bashkimit Evropian për politikat e BE në lëmin e turizmit.

Në këtë forum Ferhojgen thotë siç vijon:

„ ... edhe pse BE nuk ka kompetenca të drejtpërdrejta në turizmin, përmes partneritetit më të mirë të pushteteve publike, sektorit privat dhe të punësuarve, në nivel evropian do të gjenden përparësi të qarta për turizmin evropian. Politika kohezive evropiane është tejet e nevojshme nëse dëshirojmë ta përmirësojmë shkallën e konkurrencës së industrisë sonë dhe të krijojmë më shumë vende më të mira të punës.

Mjetet që janë në dispozicion për ta arritur këtë janë koordinimi, bashkëpunimi dhe aktivitetet përkrahëse. Për këtë qëllim i vendos themelet e politikës së përtërirë evropiane për turizëm, e cila do të implementohet përmes partneritetit midis vendeve anëtare dhe palët e involvuara në turizmin.

Qëllimi kryesor të politikës do të jetë që të përmirësohet konkurrenca e turizmit evropian dhe të krijohen më shumë vende të punës dhe vende më të mira të punës përmes zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në Evropë dhe globalisht.

Konsideroj se këto qëllime kyçe janë të përbashkëta për të gjitha palët e involvuara. Për ta transferuar këtë politikë në praktikë në periudhën e ardhshme aktivitetet tona do të fokusojmë drejt një numri më të madh të lëmive që nxisin partneritete dhe shfrytëzimin optimal të resurseve.

Politika jonë do të fokusohet në tre grupe kryesore të aktiviteteve:

- **rregullimi dhe koordinimi më i mirë i politikave;**
- **shfrytëzimi i përmirësuar i instrumenteve financiare në të cilat ka qasje, dhe**
- **aktivitete që kanë të bëjnë me problemet specifike nga lëmi i turizmit”**

Në grupin e aktiviteteve për rregullim dhe koordinim më të mirë të politikave flitet se duhet të punohet në rregullimin më të mirë përmes partneritetit, të thjeshtësohen rregullat, të mënjanohet sjellja e rregullativave për të cilat BE nuk do të jetë e sigurt nëse me të vërtetë ka nevojë për to, të koordinohen iniciativat e ndryshme për politika të cilat mund të kenë ndikësë mbi turizmin, si dhe politika detare.

Në grupin e aktiviteteve për shfrytëzimin e përmirësuar instrumente të qasshme financiare flitet për formësimin e politikës kohezive evropiane, përkrahje përmes fondeve strukturore dhe sigu-

rimin se paratë nga fondet shpenzohen në mënyrë efikase, përmes shfrytëzimi të të gjitha sinergjive të mundshme midis palëve të kyçura, projekteve dhe resurseve.

Në grupin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me problemet specifike nga lëmi i turizmit, Ferhojgen flet për përkrahje aktive të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit evropian, për themelimin e Grupit për turizëm të qëndrueshëm, punën për promovimin e trajnimeve dhe këmbim të praktikantëve, përmirësimin e qasjes në infrastrukturën për personat me lëvizshmëri të zvogëluar, promovimi i Evropës si destinacioni turistik, krijimi i portalit për atë dedikim, hulumtimi i ndikesës të evenimenteve kulturore dhe sportive mbi kompanitë turistike, shqyrtimi i zhvillimit të formave të ndryshme të turizmit, mundësitë për personat më të moshuar dhe të rinj e kështu me radhë.

Në vitin 2006 Komisioni Evropian e prezantoi komunikatën e tij Politika e përtërirë e BE për turizmin: Drejt partneritetit më të fuqishëm evropian (SOM(2006)134, teksti final i 17 marsit të vitit 2006. Kjo kornizë i merr parasysh aktivitetet dhe përvojat e kaluara dhe prezanton qasje globale që i mbulon të gjitha çështjet në lidhje me turizmin. Ajo jep pasqyrim të iniciativave të KE në lidhje me aspektet kryesore të politikave evropiane dhe mënyrat se si duhet të zhvillohen partneritetet midis palëve të involvuara. Qëllimi është të rritet vetëdija për turizmin – nga aspekti ekonomik, social dhe nga aspekti i mjedisit jetësor, si dhe të përmirësohet konkurrenca e sektorit të turizmit.

Kjo politikë është komplementare me politikat kombëtare dhe kërkon mënyra për përmirësimin e konkurrencës së turizmit evropian dhe për krijimin

e më shumë dhe vende më të mira të punës përmes zhvillimit të qëndrueshëm në Evropë dhe globalisht. Qëllimi nuk është të zëvendësohen politikat kombëtare, por të sigurohet vlera e shtuar në nivel evropian.

Një numër i madh i subjekteve private dhe publike janë të involvuar në zhvillimin e turizmit dhe, nëse dëshirojnë të jenë të suksesshëm, ata duhet të zhvillojnë partneritete.

Për këtë shkak, sukcesi i Politikës së përtërirë të BE varet nga pjesëmarrja aktive e të gjitha palëve të involvuara në turizmin. Njëra nga lëmitë fillestare për partneritet është rregullimi më i mirë. Komisioni Evropian lançoi iniciativë ambicioze në lëmi të caktuara me interes për turizmin.

Në të njëjtën kohë Komisioni Evropian, synon kah asaj që ta integrojë turizmin në të gjitha politikat e BE, dhe bëhen edhe përpjekje për të pasur koordinim përkatës të iniciativave të ndryshme të cilat mund të ndikojnë në turizmin.

Qëllimi tjetër i rëndësishëm i politikës së përtërirë është që turizmi të shfrytëzohet sa është e mundshme më tepër instrumente financiare të Unionit. Turizmi njëmend merr përkrahje përmes Fondit Evropian për Zhvillimin regjional (EFZHR), Fondit koheziv, Fondit Evropian social, Fondit Evropian bujqësor për zhvillim rural, Fondit Evropian për peshkatarë, por edhe nga Programet e bashkësisë siç janë Programi i shtatë kornizë, Programi i integruar për mësim deri në fund të jetës, Programi kornizë për konkurrencë dhe inovacione e kështu me radhë.

Qëllim i rëndësishëm i politikës është përkrahja aktive e qëndrueshmërisë së aspektit ekonomik dhe

social dhe aspektit të ambientit jetësor të turizmit evropian sepse këto janë faktorë kyç për konkurrencën e destinacioneve dhe pasurisë së njerëzve, si dhe për krijimin e vendeve të punës, ruajtjen dhe përmirësimin e bukurive natyrore dhe kulturore.

Komunikata e Komisionit Evropian e titulluar si Agjendë për zhvillim të qëndrueshëm dhe konkurrues (COM(2007) 621, teksti final nga 19 tetori i vitit 2007) përshkruan hapa për promovimin e qëndrueshmërisë dhe konkurrencën të turizmit evropian. Me pjesëmarrje në implementimin e kësaj agjende palët e involvuara në turizmin do ti mbrojnë mjetet dhe përparësitë e konkurrencës që bëjnë Evropa të jetë destinacioni më atraktiv për të gjithë shtetasit e huaj, por edhe për Evropianët. Palët e involvuara janë të thirrura që ti pranojnë përgjegjësitë e tyre në nivelet në të cilat më shpesh punojnë dhe ti pranojnë mundësitë që i ofron sfida e qëndrueshmërisë, si lëvizës potencial për inovacione dhe rritje. Ato duhet ti ndajnë të njëjtat qëllime, për bashkuar përpjekjet e tyre në mënyrë më të dukshme dhe sinergjike. Menaxhimi i qëndrueshëm me destinacionet, integrimi i interesave të qëndrueshme nga bizneset dhe vetëdija e qëndrueshme nga turistët e formësojnë kornizën e aktiviteteve në të cilën duhet të respektohen parimet e qëndrueshmërisë. Komunikata, poashtu, e vë në pah dedikimin e Komisionit Evropian në lidhje me agjendën e theksuar më lartë.

Promovimi i dukshmërisë së turizmit evropian është edhe një qëllim i rëndësishëm e politikës së përtërirë. Ky qëllim duhet të arrihet përmes përpjekjeve të përbashkëta të sektorit privat dhe publik. Shembull për këtë është organizimin i forumeve evropiane për turizëm. Mjet efikas është edhe portali evropian për destinacioni turistike në Evropë www.visiteurope.com

Poashtu, në vitin 2006 Komisioni Evropian e lancoi iniciativën EDEN, e cila u transformua në aktivitet përgatitor në dhjetor të vitit 2007.

E ballafaquar me konkurrencën e shtuar të turizmit global, e në drejtim të përmirësimit të turizmit evropian, KE miratoi edhe disa iniciativa tjera.

Kështu, më 15 maj të vitit 2008 u shpall thirrja për Program Kornizë për konkurrencë dhe inovacione “Rrjete për konkurrencë dhe qëndrueshmëri të turizmit evropian” (ENT/CIP/08/B/N05S00). Qëllimi ishte të përkrahen iniciativat nga subjektet private dhe publike, rrjetet e tyre ekzistuese, si dhe të vihet theks në përforcimin e kapaciteteve të qëndrueshme dhe nxitjen e konkurrencës që kompanive të vogla dhe të mesme nga lëmi i turizmit.

Në vitin 2009 u përpilua dokumenti për diskutim i titulluar si “Kornizë e re për politikën e turizmit të BE”. Ky dokument flet për ndërmarrjen e iniciativave nga ana e BE që do të jenë të orientuara kah përkrahja, koordinimi dhe plotësimi i masave që janë ndërmarrë nga shtetet-anëtare, përmes iniciativave që kanë dimension multidimensional ose së paku dhe evropian dhe vlerë të shtuar të lartë, në krahasim me iniciativat tërësisht regionale ose kombëtare. Kjo kornizë për politikën e BE për turizëm si qëllime kryesore duhet ti propozojë qëllimet vijuese::

- të stimulohet konkurrenca e industrisë turistike;
- të përforcohet zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Evropë, dhe
- të promovohet Evropa në tregjet kryesore në vendet e treta.

Më tej, për çdo njërin nga qëllimet e propozuara, dokumenti përmban edhe propozim-aktivitete për realizimin e qëllimeve.

Në konferencë për palët e involvuara në turizmin, të mbajtur në Madrid më 14-15 prill të vitit 2010, u miratua dokumenti i titulluar si “Vizioni strategjik për politikën e turizmit në BE”.

Qëllimi ishte të përkrahen iniciativat nga subjektet private dhe publike, rrjetet e tyre ekzistuese, si dhe të vendoset theksi në përf forcimin e kapaciteteve të qëndrueshme dhe në nxitjen e konkurrencës të kompanive të vogla dhe të mesme nga lëmi i turizmit.

Zëvendës-kryetari Antonio Taxhani, përgjegjës për industrinë dhe ndërmarrjet, deklaroi se “turizmi është njëri nga aktivitetet ekonomike me potencial më të rëndësishëm për gjenerimin e rritjes së ardhshme dhe punësimin në BE. Ashtu si edhe sektorët ekonomik, edhe turizmi ishte i prekur nga kriza ekonomike, por tu dëshmuua se është njëri nga sektorët më rezistues, që para do kohësh tregon madje edhe shenja të këndelljes dhe rritjes së caktuar.”

Në konferencën u diskutua edhe për disa tema specifike, siç janë inovacionet dhe konkurrenca, qëndrueshmëria dhe zhvillimi i përgjegjshëm social, si dhe mënyrat për përf forcimin e imazhit të Evropës si destinacioni turistik.

Rezultati nga konferenca do ta hap rrugën për qasje të koordinuar dhe koherente ndaj iniciativave për politikën e turizmit që do të ndërmerren në nivel evropian. Pritet që nga kjo të rrjedh deklarata që do të prezantohet para Komisionit.

3.2 Politika për turizmin në BE

Në pajtim me strategjinë e re të Lisbonës, BE është e fokusuar ndaj zhvillimit më intensiv dhe krijimit të më tepër dhe vendeve më të mira të punës. Me vendet e ndryshme atraktive dhe me cilësinë e shërbimeve turistike, Evropa është destinacioni prijës në botë. Për këtë shkak, turizmi është aktivitet që mund të luajë rol të rëndësishëm në realizimin e qëllimit të rritjes dhe hapjes së vendeve të reja të punës.

Ndryshimi i strukturës demografike e Evropës do të ketë ndikese më të madhe mbi turizmin. Numri i njerëzve më të moshuar se 65 vjet do të vazhdojë të rritet, e me përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe shtimin e jetës së njerëzve pritet edhe fuqi më e madhe konsumi në krahasim me gjeneratat paraprake. Për këtë shkak, do të duhet të rritet edhe numri i njerëzve më të moshuar se 50 vjeç të cilët më shpesh udhëtojnë.

Përveç rritjes së kërkesës për turizëm, pritet edhe ndryshimi i kërkesës së llojeve të ndryshme të turizmit. Rritje më e madhe pritet në sferën e turizmit shëndetësor dhe turizmin në lidhje me pasuritë kulturore dhe natyrore.

Komisioni ka ndërmend të miratojë politikë të përtërirë për turizmin në BE, në sajë të përvojave të deritanishme dhe në përgjigje të sfidave të sotme. Qëllimi kryesor i politikës do të jetë **përmirësimi i konkurrencës së turizmit në BE dhe të krijohen më shume dhe vende më të mira të punës përmes zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në Evropë dhe në nivel global.**

Përdorimi i instrumenteve financiare të BE në të cilat ka qasje

Turizmi shfrytëzoi mjete të rëndësishme nga përkrahja financiare e ofruar nga instrumentet e ndryshme financiare të BE. Në periudhën mes viteve 2007–2013, fondet strukturore dhe programet tjera të BE me financa do ta përkrahin zhvillimin e turizmit, shërbimeve dhe të infrastrukturës.

Komisioni parasheh mundësi për financimin e projekteve për turizëm të qëndrueshëm përmes Fondit Evropian për zhvillim regjional (FEZHR), si dhe përkrahje e zhvillimit socio-ekonomik. Sipas qëllimeve për “Konvergjencë”, “Konkurrencë dhe punësim” dhe “Bashkëpunim territorial Evropian”, FEZHR duhet të përkrah më tepër modele të qëndrueshme të turizmit, për ta shtuar pasurinë kulturore dhe natyrore, për të zhvilluar infrastrukturën qasëse, për ta promovuar THK, NMV inovative, biznes – rrjetet dhe klasterët, shërbimet me vlerë më të lartë të shtuar, strategjitë e përbashkëta tejkufitar për turizëm dhe këmbimin e përvojave midis regjioneve.

Infrastruktura transportuese dhe infrastruktura e ambientit jetësor, të cilat janë me rëndësi më të madhe për turizmin, poashtu janë të financuara nga Fondi koheziv.

Fondi i ri Evropian për zhvillim rural (European Agricultural Fund for Rural Development) do të sigurojë përkrahje në drejtim të:

- **përmirësimi të cilësisë së prodhimit të bujqësore dhe të prodhimeve;**

- **përmirësimi të ambientit jetësor dhe të ambientit natyror;**
- **inkurajimit të aktiviteteve turistike, si pjesë të diversifikimit të tërë ekonomisë rurale, dhe**
- **studime dhe investime të ndërlidhura me mirëmbajtjen, restaurimin dhe mbindërtimin e trashëgimisë kulturore.**

3.3 Programe dhe iniciativa që janë aktuale në BE

Kalipso (Calypso) – turizëm social

Turizmi social ju mundëson shumë njerëzve që të shkojnë në pushim dhe kjo në mënyrë të konsiderueshme e përmirëson lëvizshmërinë. Poashtu, turizmi social ndihmon që të tejkalohen udhëtimet sezonale, mundëson të realizohet ideja për përforcimin e të ndjenjës se janë banorë të Evropës dhe të promovohet zhvillimi regjional.

Qëllimet kryesore në vitin e parë përgatitor janë: grumbullimi i përvojave më të mira për nxitjen e turizmit në pjesën jo sezonale, e më këtë edhe rritje e punësimit; mundësi që personat më në moshë, personat e ri, personat invaliditet dhe familjet të cilat ballafaqohen me vështirësi sociale të udhëtojnë përmes programeve të ndryshme tematike, këmbime dhe oferta për vendosje, hulumtim i problemeve nga përvojat dhe propozimi i zgjidhjeve përkatëse e kështu me radhë.

Përmes rritjes së qasshmërisë së turizmit për grup moshë të ndryshme, ky turizëm mundëson përmirësim të të hyrave nga turizmi, e me këtë edhe

përmirësim të mundësive ekonomike dhe mundësive për punësim, të cilat nga ana tjetër janë qëllime kyçe të strategjisë së Lisbonës. Rritet turizmi jo sezonal, posaçërisht në regjionet e zhvilluara, ku turizmi është kryesisht sezonal, dhe jep mundësi edhe për promovimin e destinacioneve, më pak të njohura.

Bashkëpunimi në turizmin

Nevoja për përmirësimin e të dalluarin turizmit kërkon bashkëpunim të fuqishëm midis organizatave, administratës publike, destinacioneve dhe palët tjera të involvuara.

Komisioni tanimë bashkëpunon me palë të ndryshme, mirëpo nëse kihet parasysh fakti se Komisioni nuk ka kompetenca të drejtpërdrejta mbi turizmin, një numër i madh i sferave në politikat tjera evropiane kanë ndikësë të konsiderueshme mbi rritjen e turizmit. Për shembull, një numër i madh i aktiviteteve nga lëmi i sportit, arsimit, trajnimit, rinisë, kulturës, politikës regjionale e kështu me radhë janë të përkrahura përmes programeve tjera të BE.

Përkrahja statistikore është njëri nga mjetet kryesore të nevojshme për kuptimin më të mirë të sektorit të turizmit. Përfundimi i Rregullativës së re për statistika në lëmin e turizmit është në fazë të përpunuar dhe pritet që të hyjë në fuqi në vitin 2010. Njëkohësisht, Komisioni bashkë me shtetet-anëtare dhe në bashkëpunim me OECD dhe Organizatën Botërore turistike e promovon aplikimin e një kornize statis-

tikore statistikore me të cilat do të maten të mirat dhe shërbimet në lëmin e turizmit me standardet, klasifikimet dhe definicionet ndërkombëtare, me çka do të mundësohet krahasim nga një në vend tjetër.

Përforcimi i njohjes së turizmit është edhe një qëllim i rëndësishëm, Programet EDEN dhe Kalipso janë në drejtim të realizimit të këtij qëllimi.

Në drejtim të përmirësimit të bashkëpunimit me aktorët tjerë në sektorin turistik, e me qëllim që të përforcohet turizmi evropian, Komisioni propozoi kornizë operative përmes organizimit të evenimenteve të shumta. Evenimentet e këtylla janë të rëndësishme për përmirësimin e ndërlidhjes midis të gjitha palëve në turizmin evropian. Njëra nga masat e propozuara është edhe Forumi vjetor Evropian për turizëm, në të cilin tubohen më tepër se 300 përfaqësues prijës nga sektori i turizmit, shoqërisë civile, institucionet evropiane, përfaqësues kombëtar nga lëmi i turizmit dhe organizata ndërkombëtare për të diskutuar për sfidat në sektorin. Çdo vit Forumi fokusohet në temë të ndryshme.

Destinacione evropiane të të përkryerës (European Destinations of Excellence - EDEN)

Komisioni Evropian e udhëheq projektin EDEN që nga viti 2006. Qëllimi i kësaj iniciative është dyanësh: të tërhiqet vëmendje në vlerën, diversitetin dhe karakteristikat e destinacioneve turistike në BE, si dhe të promovohen destinacioni ku rritja ekonomike është e zbatuar në atë mënyrë që të sigurojë qëndrueshmëri

të turizmit nga aspekti social kulturor dhe nga aspekti i ambientit jetësor.

Qëllimet e këtij aktiviteti janë:

- **përmirësimi i dukshmërisë se destinacioneve të caktuara, posaçërisht të atyre më pak të njohura;**
- **krijimi i vetëdijes për diversitetin dhe cilësinë e turizmit evropian;**
- **promovimi i të gjitha shteteve dhe regjioneve evropiane;**
- **orientimi i udhëtimeve turistike drejtë destinacioneve jo tradicionale dhe promovimi i turizmit jo sezonal, dhe**
- **gjetje e formave të qëndrueshme të turizmit, krijimi i platformës për këmbimin e përvojave më të mira në nivel të BE.**

Temat për iniciativat janë këto që vijojnë:

- **Viti 2007 – Destinacione më të mira “të reja” rurale në Evropë (10 shtete - pjesëmarrëse)**
- **Viti 2008 – Turizmi dhe trashëgimia e pa prekur lokale (20 shtete - pjesëmarrëse)**
- **Viti 2009 – Turizmi dhe rajonet e mbrojtura (22 shtete - pjesëmarrëse)**
- **Viti 2010 – Turizmi ujqor (25 shtete - pjesëmarrëse)**
- **Viti 2011 – regjenerimi i rajoneve fizike (27 shtete - pjesëmarrëse - ?)**

Promovimi i qëndrueshmërisë dhe konkurrencës së turizmit

Turizmi është aktivitet që mund të ketë ndikësë me të vërtetë të madhe mbi zhvillimin e qëndrueshëm. Qëndrueshmëria e turizmit evropian thërret në bashkëpunim proaktiv midis kompanive turistike, destinacioneve turistike dhe pushteteve kombëtare, regjionale dhe lokale, me qëllim që të përfshihet një grup i gjerë sfidave, e në të njëjtën kohë të mbetesh konkurrues.

Në tetor të vitit 2007, Komisioni Evropian e miratoi agjendën për turizëm të qëndrueshëm dhe konkurrues evropian. Me këtë agjendë, Komisioni Evropian e ndërton kornizën për implementimin e politikave dhe aktiviteteve evropiane për përkrahje të turizmit dhe të lëmive tjera që kontribuojnë për qëndrueshmërinë e tij.

Zhvillimi qëndrueshëm – Shteg nëpër perden e hekurt

Komisioni organizoi tre punëtori regjionale për ngritjen e vetëdijes për “Shtegun nëpër perden e hekurt” – udhëtim i ardhshëm euro-çiklistik.

Çdo punëtori tubon pjesëmarrës nga niveli lokal, regjional dhe kombëtar i pushtetit dhe të interesuar tjerë, si dhe media nga shtetet-anëtare dhe nga vendet-kandidate me qëllim:

- **për tu theksuar rëndësia e shtuar e turizmit çiklistik, përfitimet nga ai, efekti ekonomik për regjionet, si dhe të theksohet rëndësia e zhvillimit të Shtegut nëpër perden e hekurt, si trase çiklistike;**

- që të prezantohen përvojat evropiane nga turizmi çiklistik nga udhëtimet tjera çiklistike;
- që të hulumtohen interesat e shteteve dhe të regjioneve të vendosura përgjatë perdes së mëparshme të hekurt për implementimin e shtegut të këtillë çiklistik dhe identifikimin e iniciativave të zbatueshme, që KE të mund të ndihmojë në implementimin në vitin 2010 dhe 2011, dhe
- për ta promovuar lidhjen në rrjet të regjioneve dhe të shteteve të vendosura përgjatë perdes së mëparshme të hekurt si shteg të ardhshëm.

Punëtoritë duhet të jenë pikënisje për krijimin e rrjetit të shteteve dhe të regjioneve që do të jenë të interesuara për implementimin e projektit. Punëtorja e parë u mbajt më 19 nëntor të vitit 2009 në Varshavë, Poloni, e dyta më 9 dhjetor në Sopron, Hungari, e treta më 16 mars të vitit 2010 në Sofje, Bullgari. Çdo punëtori kishte shtete të ndryshme si grup të qëllimit.



PROJEKTE QË KANË SHFRYTËZUAR PARA EVROPIANE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT ALTERNATIV

Në vazhdim prezantojmë disa projekte nga pjesë të ndryshme të Evropës të cilët kanë shfrytëzuar fonde evropiane. Një numër i madh nga ju mundet do ta

gjejnë veten ose në ndonjërin nga këto projekte do të shohin mundësi të cilat, në masë të madhe, mund të realizohen edhe tek ne.

1. Në këmbë nëpër viset Hajlends

Bukuria e peizazhit dhe tradita e pasur kontribuuan që viset malore Hajlends të bëhen regjion jashtëzakonisht i popullarizuar në Skoci. Me majat e larta, numrin e madh të përrenjve dhe lumenjve, liqeneve dhe fJORDEVE dhe luginave të pjerrëta, regjioni disponon me pothuajse të gjitha atraksionet të cilat do ti pushtojnë edhe vizitorët më të bezdisur. Por, edhe shumë njerëz duhet të dëgjojnë për këtë vend i cili shkakton lemeri dhe shumë njerëz duhet që tani të fillojnë ta zbulojnë, për shkak se viset malore Hajlends janë regjioni më i lënë pas dore në Skoci



Duke e pasur këtë në mendje, në vitin 1999 organizata Hajlend festivali shëtites e organizoi eventin e parë me përkrahje nga programi Evropian Lider II. Pakoja është me të vërtetë tërheqëse: oferta prej më tepër se 20 shëtitje me ciceron dhe mundësi që pjesëmarrësit ta zbulojnë çdo aspekt nga peizazhet spektakolare të vendit. Ndërsa mundësitë që ofrohen janë nga më të ndryshme: piknikë malore, shëtitje në pyje, vizitë vendeve historike.... Çdo piknik është i menduar ashtu që të ofrojë përvojë origjinale - nga shëtitje të rënda shtatorëshe deri në shëtitje të lehta familjare. Janë përfaqësuar të gjitha nivelet e përgatitjes teknike, kështu që pakoja është atraktive për publikun më të gjerë.



Kontakti:

z-nja Fran Cree
Kryetar i Këshillit Drejtues

Adresa:

Rua Reidh Lighthouse, Gairloch

Telefoni:

+44 1445 771263

Burimi i financimit:

LIDER II

Buxheti i tërësishëm:

1.808 euro

Kontribut i Bashkimit Evropian:

816 euro

Promotorët dëshirojnë ta bëjnë Festivalin ngjarje vjetore, me qëllim që ta krijojnë dhe ta ruajnë interesimin për këto rejtore të egra dhe ti tërheqin vizitorët edhe jashtë sezonit. Përfitimet do të kishin qenë: prolongimi i ndikesës ekonomike të sezonit turistik dhe besimi në faktin se pasi një herë do të vijë, njerëzit me siguri do të dëshirojnë të vijë sërish





2. Eko- shtëpi në Korrushkë

Maja më e lartë në Austri Grosglokner, i cili në majën më të lartë arrin 3.797 metra, dhe akullnaja Moltal e kanë dhënë emrin e regionit përreth. Këto bukuri të Korrushkës juglindore karakterizohen me peizazhe madhështore malore dhe florë e faunë jashtëzakonisht të ruajtur. Kjo është pasuri që duhet të ruhet dhe të zhvillohet.

E vetëdijshme se ky ambient është atraksioni më i madh në regjionin dhe se ofron cilësi të pa krahasueshme të jetës, bashkësia lokale bëri shumë përpjekje në politikën aktive për mbrojtjen e ambientit jetësor. Intenca është e qartë: të sigurohet simbioza midis aktivitetit të njeriut dhe mbrojtja e këtij ambienti të jashtëzakonshëm natyror.





Një nga shenjat e këtij dedikimi është ajo që disa biznese të vogla në luginën Moltal, me ndihmën e programit Lider II, bënë grup punues i cili si qëllim të vetin e vendosën ndërtimin dhe shitjen e shtëpive ekologjike. Parashenja ekologjike mund të miratohet në disa baza: shtëpitë janë të ndërtuara nga druri, sistemi i izolimit për ngrohje përdor letër të ricikluar, konsumi është i minimizuar përmes shfrytëzimit të burimeve të energjisë së përtëritshme ose shfrytëzimit të sistemit të ngrohjes që shpenzon pak energji. Përparësi e rëndësishme është ajo që procesi i gjithëmbarshtëm i prodhimit zhvillohet lokalist, me ç'rast ka efekt të shkëlqyer mbi zhvillimin e numrit të madh të bizneseve lokale dhe hapjen e vendeve të punës. Gjithsesi, investimi në mbrojtje cilësore ekologjike në lëmi e cila nuk ka përparësi tjera dhe ku turizmi është burim kryesor i të hyrave është si nxjerrje e policave të sigurimit për tërë rajonin.

Kontakti:

z-tri Gunther Marwieser

Adresa:

Regionalverein Grossglockner/Molltal
Mortschach 42
A-9842 Mortschach

Telefoni:

+43 4826 707

Faksi:

+43 4826 7074

E-mail:

region@grossglockner.or.at

Burimi i financimit:

LEADER II

Buxheti i tërësishëm:

2.180.233 euro, përfshirë edhe 85.755 euro
(marketing dhe organizim)

Kontribut i Bashkimit Evropian:

42.877 euro

3. Parajsja çiklistike për të gjithë

Midis viteve 1997 dhe 1999 BE siguroi mjete për përkrahjen e programit për turizëm çiklistik Pincgau, projekt në të cilin bashkëpunonin 28 bashkësi lokale me qëllim të vendosjes së rrjetit të shtigjeve çiklistike. Qëllimi ishte që të shfrytëzohen përparësitë e turizmit çiklistik, si një nga sektorët më të suksesshëm turistik, për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë në regjionin..





Me ndihmën e programit Salzburg Objective 5b, përgjatë tërë shtegut çiklistik Tauern, si dhe në shtigjet e reja të ndërtuara, u vendosën shenja të unifikuara dhe që dallohen lehtë. Poashtu, ishin të vendosura edhe nëntë pikë informimi për pushim me tabela informative me mbulesë, burime, tavolina dhe karrige, si dhe vend për ushtrim për ushtrime gjimnastikore për çlodhje. Poashtu, ishte e siguruar përkrahje për botimin e hartave të kuptueshme lehtë për shtigjet çiklistike për tërë rajonin Pincgau dhe për organizimin e evenimenteve që do të orientohen drejtë të gjitha elementeve të ndërlidhura me çiklizmin. Pincgau është lider në këtë sektor në Austri, me rrjet të shtigjeve çiklistike në gjatësi prej mbi 1.200 km. Këtu ka çdo gjë që mund të dëshirojë një çiklist – nga shtigje ekstreme malore për biçikleta në regjionin me vise me shkëmbinj, e deri në shtigje të relaksuara rrafshinore në fund të luginës.

Shpenzime të tërësishme:

494.000 euro

Burimi i financimit:

Fondi evropian për zhvillimin regjional:
51.742 euro

Kontakt informacione:

Ernst Demel
Verein Pincgauer Radverkehrsnetz
A-5092 St. Martin bei Lofer

Telefoni:

(43-6588) 85 10

Faksi:

(43-6588) 85 10 75

E-mail:

info@salzburgerland.com

Internet:

Finding one's way in the Pincgau cycling network



4. Me biçikletë rreth Detit Verior

Çiklizmi, si mënyrë e lirë e udhëtimit, kërkon infrastrukturë të vogël dhe ka efekt të vogël negativ mbi ambientin jetësor, e poashtu fiton edhe në popullaritet në tregun rekreativ. Gjashtë shtete që dalin në Detin Verior i bashkuan forcat për të krijuar shteg të pandërprerë çiklistik përgjatë bregut të detit, me ndërlydheje me traketë, me qëllim të nxitjes së pushimeve me biçikletë. Projekti u përkrah nga partneritet shumë i madh, përfshirë aty edhe pushtetet lokale dhe ato regjionale, organizatat turistike dhe transportuesit, si dhe nga një numër i madh i organizatave në Gjermani, Danimarkë, Holandë, Mbretërinë e bashkuar si dhe në Suedi. Projeksionet e bëra në sektorin turistik treguan rritje të madhe të numrit të pushimeve të kaluara në udhëtime me biçikletë, që mund të rezultojë me rezultate të konsiderueshme ekonomike

I filluar në vitin 1998, projekti për shteg transnacional çiklistik e kyçi transportin me traket për të siguruar shteg të vazhdueshëm rreth Detit Verior. Midis përfitimeve të pritura ishin edhe krijimi dhe ruajtja e vendeve të punës në aktivitetet e qëndrueshme turistike, promovimi i aktiviteteve tjera të ndërlidhura me turizmin kulturor dhe krijimin e vetëdijes për pasurinë natyrore dhe kulturore të regjioneve të vizituara. Iniciativa e filluar me studim për mundësi të realizimit të ndërlidhjes me traketë të shtigjeve ekzistuese, me qëllim që të definohet nevoja për lidhje plotësuese. Pas marrjes së këtij informacioni, kah fundi i muajit maj të vitit 1999 partnerët miratuan strategji të përgjithshme të bazuar në idenë se promovimi ndërkombëtar i shtegut duhet të mundësojë depërtim më të fuqishëm në tregun, se sa do të mund ta bëjë çdo vend veç e veç ose regjionet në mënyrë të ndarë.

Me shfrytëzimin, para së gjithash marshrutat ekzistuese, shtegu çiklistik rreth Detit Verior është hapur nga viti 2000. Gara inauguruese përgjatë tërë shtegut – nga Hamburgu, Gjermani deri në Aberdin, Skoci – organizua që të shënohet fillimi zyrtar i shtegut të tërësishëm që u përfundua në mes të vitit 2001. Broshura promovuese, e botuar në 6 gjuhë (në danisht, holandisht, anglisht, gjermanisht, norvegjisht dhe suedisht), kyç edhe hartë që mund të shfrytëzohet për planifikimin e pushimit me biçikletë dhe udhëzim me informacione për destinacionet kryesore. Shtegu është i promovuar edhe në Internet, ku është vendosur kalendar me aktivitete.



Kontakti:

Rogaland Fylkeskommune
Regionalplanavdelingen
Postboks 798
NO-4001 Stavanger

Telefoni:

(47-51) 51 66 81

Faksi:

(47-51) 51 66 74

E-mail:

pfp@rfk.rogalandf.kommune.no

Internet:

www.northsea-cycle.com

Programi:

Interreg II C regjioni i Detit Verior

Projekti:

North Sea cycle route

Shpenzime të tërësishme:

770.960 euro

Kontribut i Bashkimit Evropian:

385.480 euro

5. Burimet e lumenjve në luginën e Lisbonës dhe Tagusit

Projekti ekoturistik në regionin e luginës së Lisbonës dhe Tagusit ndihmoi për përparimin e zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve të lumenjve Alviela, përmes integritimit të ekoturizmit me vetëdijen për ambientin jetësor, si dhe me edukim dhe hulumtime shkencore.

Aktivitetet në eko-projektin e përfshinë ndërtimin e një qendre me dedikim të shumëfishtë që gjendet në afërsi të burimeve të lumenjve Alviela, por poashtu edhe në afërsi të plazhit e lumit, në hapësirën për kampim, si dhe në Parkun Kombëtar Sera de Aire. Rrethina që rrethon këtë qendër, si dhe pjesa tjetër e parkut, është lëmi me bukuri të jashtëzakonshme natyrore dhe ka domethënie tejet të madhe nga pikëpamja gjeologjike, hidrologjike dhe ekologjike. Për këtë shkak, u zhvillua strukturë e jashtme dhe u ndërtuan shtigje me qëllim që të vëzhgohet ekosistemi i lumit dhe karakteristikat e afërta gjeologjike dhe morfologjike. Elementet tjera e kyçën edhe ndërtimin e pendës së vogël, me qëllim që të rritet sipërfaqja ekzistuese për larje, për zhvillim të karakteristikat turistike, duke e përfshirë edhe një pjesë për pushim dhe një pjesë për kampim.

Kjo qendër me më shumë dedikime përfshin dhe promovon një vëllim të gjerë të aktiviteteve të ndryshme, midis të cilave edhe shpellë me lakuriqë nate me qendër monitorimi, ku përmes video monitorimit mundësohet hulumtim shkencor, ndërsa vizitorët mund të dëshmojnë për jetën e vetmuar të këtyre sisorëve, si dhe geodrom i cili, në esencë jep pasqyrë të evolucionit gjeologjik në rajonin. Qendra përm-



ban edhe lokale për ushtrime, qasje pa pagesë në Internet, bibliotekë tematike, hapësira për ekspozita të përkohshme, restorant për vetëshërbim dhe vendosje për rreth 60-të personave. Projekti ishte i udhëhequr nga autoritetet komunale. Partnerët tjerë në projektin ishin organizata shkencore dhe arsimore, Agjensioni për zhvillim lokal, Agjensioni për rregullimin e ujërave dhe një kompani lokale për furnizim me ujë.



Kontakti 1:

Luís Manuel da Silva Azevedo or Eduardo Marcelino Ramalho Camacho
City Council of Alcanena
Praça de Maio, 8
P-2380-037 Alcanena

Telefoni:

(351) 249 88 90 10

Faksi:

(351) 249 89 13 57

E-mail:

ambiente@cm- alcanena.pt

Internet:

<http://www.cm-alcanena.pt>

Kontakti 2:

Maria João Botelho
Natural Park of the Aire and Candeeiros Mountain Range
Rua Dr António César Silva Ferreira
Bairro do Matão
P-2040-215 Rio Maior

Telefoni:

(351) 243 99 94 80

Faksi:

(351) 243 99 94 88

E-mail:

pnsac@icn.pt

Internet:

<http://www.icn.pt>

Projekti:

Ecotourism — The Alviela river springs

Programi:

Qëllimi 1

Shpenzime të tërësishme:

3.710.000 euro

Kontribut i Bashkimit Evropian:

2.517.000 euro



6. Qendra termale e cila e rriti numrin e vendeve të punës dhe i siguroi vendet ekzistuese të punës

Projekti më i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të komunës Geinberg, në afërsi të Lincit, Austri, gjatë viteve të kaluara, ishte fillimi i punës së qendrës termale. Kombinimi i banjave dhe ujërave termale, objekteve sportive, sauna qendrës dhe qendrës për

shëndet janë përparësi e rëndësishme konkurruese. Kombinimi i turizmit me përmirësimin e shëndetit në mënyrë të konsiderueshme e shtoi atraktivitetin e lokacionit.





Vendosja dhe puna e qendrës termale ruajti dhe krijoi gjithsej 400 vende pune, me numër të shtuar të vizitorëve të cilët i shfrytëzuan përparësitë e hotelit lokal, posaçërisht të shërbimeve për ushqim. Programet e llojllojshme të ofruara që i ofron qendra janë të orientuara drejt grupeve të ndryshme të qëllimit.



Kontakti:

Tayfun Ucar
THG Thermenzentrum Geinberg Errichtungs
GmbH
Rudolfstraße 53
A-4040 Linz

Telefoni:

(43-732) 70 09 90

Faksi:

(43-732) 71 77 39

E-mail:

vamed.linz@magnet.at

Internet:

www.therme-geinberg.at/

Shpenzime të tërësishme:

42.100.000 euro

Kontribut i Bashkimit Evropian: Fondi Evropian për zhvillim regional:

2.240.000 euro



7. Rindreqje në Mistras

Duke luftuar me bukuritë e ambientit natyror, rrënojat mesjetare të Mistrasit, të larguara 5 km nga Sparta, e formësojnë njërin nga vendet më të rëndësishme arkeologjike të Greqisë. Këto mure janë, poashtu, në listën e përmendoreve të trashëgimisë kulturore botërore të UNESCO-s. Me rrugët e ngushta, fortifikimet e larta, shtëpitë e vogla, shtëpizat për vikend, pallatet, koshëzat dhe manastiret si dhe kishat përplot freska, Mistrasi është shembull unik i arkitekturës madhështore religjioze por edhe jo kishtare dhe është pasqyrim i qytetit tipik nga periudha e vonshme bizantine (1262–

1460). Qëllimi i projektit të financuar nga FEZhR ishte që Mistrasi të shndërrohet në kompleks të integruar muzeu, ku vizitorët mund ti zbulojnë të gjitha aspektet e kësaj kulture. Me që shumë ndërtime fetare tanimë kishin qenë të restauruara, projekti u orientua drejtë gërmadhave jo kishtare. Midis më të rëndësishmet hynë pallati i despotëve, me strukturat e saja bizantine dhe zbukurimet gotike. Një nga punët kryesore të projektit përfshiu rekonstruimin e pullazit të madh të sallës me fronin të bërë nga druri i arrës, me tabela të dyfishta dhe me tjegulla të punuara me dorë.

Përveç në pallatin, u punua edhe në konsolidimin e kështjellës së Frankëve në majë të kodrës, në shtëpitë në qytetet më sipër, meremtoheshin pullazet e selisë së fronit Agios Dhimitrios, por u rikonstruktua edhe nënpullazi verior dhe perëndimor të manastirit Pantanasa. Një pjesë e punimeve përfshinë edhe vendosjen e pllakave në rrugët dhe instalimin e sistemit për ujë dhe rrymë elektrike e kështu me radhë.



Pjesa më e madhe e punëve u realizuan në periudhën prej vitit 1995 deri në vitin 2001. Projekti në total krijoi 21 vend pune me orar të plotë të punës dhe 63 vende sezonale të punës. Poashtu, u punësuan edhe dy arkitektë, dizajner, inxhinier, inxhinier kimie, topograf dhe nëpunës administrativ, si dhe një ekipi nga tre arkeologë që u punësuan për një kohë të caktuar.

Projekti:

Restoration of the Mystras monuments

Kontakti:

Ministry of Culture
Committee for the Restoration of the Mystras
Monuments
Leonidou 96
GR-23100 Sparta
c/o Prof. Stephanos Sinos

Tel/faksi:

(30) 27 31 02 15 41

E-mail:

eamystra@otenet.gr

Internet faqja e regjionit:

http://www.peloponnisos.gr/intro_en.htm

Shpenzime të tërësishme:

2.935.000 euro

Kontribut i Bashkimit Evropian (Fondi Evropian për zhvillim regional):

2.201.000 euro



8. Qendra informative në parkun kombëtar

I themeluar në vitin 2000, parku Kombëtar në luginën taja është vazhdimësia austriake e parkut kombëtar Podi në Republikën e Çekisë, i cili është hapur në vitin 1991. Ky ishte projekt për konservimin e natyrës, e njëkohësisht edhe instrument për përshpejtimin e zhvillimit lokal përmes turizmit, i cili duhet ta gjeneronte zhvillimin.

Karakteristikë kryesore ishte ndërtimi i qendrës informative. Qendra siguron një spektër të informacioneve turistike dhe është pikë fillimi për të gjitha ekskursionet në parkun. Lokalet për shpjegim dhe edukim ju mundësonin vizitorëve të njoheshin me evolucionin e parkut dhe me proceset natyrore, ekologjinë në

parkun dhe aktivitetet tejkufitar për mbrojtjen e ambientit jetësor. Në hapësirën e ekspozitave vizitorët mund nga afër të njihen me historinë lokale të vjetër me miliona vite, e mandej të vijnë seminare për mbrojtjen e natyrës, si dhe të dëgjojnë shumë tema tjera nga lëmi i ambientit jetësor.

Parku e thekson posaçërisht edukimin e fëmijëve dhe të njerëzve të rinj nga lëmi i mjedisit jetësor, por poashtu edhe një numër i madh i aktiviteteve në vend të hapur edhe nëpër hapësirat e mbyllura janë të dizajnuara për grupe shkollore dhe të të rinjve. Poashtu, projekti ju dedikua edhe adhuruesve të natyrës dhe shkencëtarëve.

Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me parkun kombëtar çek janë përmirësuar udhëtimet tejkufitar,



por ekziston edhe program për menaxhimin e përbashkët me parkun, gjë e cila realizohet përmes dy ekipeve të menaxhimit.

Në qendrën për vizitorë çdo vit qëndrojnë rreth 25.000 njerëz. Rreth 16% prej tyre janë nxënës, 25% njerëz që vinë në ekskursione dhe shëtitje, ndërsa 17% janë vizitorë të ekspozitave. Me hapjen e Qendrës janë punësuar tre persona me orar të plotë pune, ndërsa nëntë të tjerë janë punësuar me kontratë të përkohshme. Hapat e ardhshëm janë në sferën e raporteve me opinionin, me qëllim që edhe më tej të rritet numri i vizitorëve.

Kontakti:

Robert Brunner, Nationalpark Thayatal GmbH

Telefoni:

+43 2949 7005

Faksi:

+43 2949 700550

Adresa:

Merkersdorf 90
A-2082, Hardegg, Österreich

E-mail:

office@np-thayatal.at

Internet:

www.np-thayatal.at
(www.nppodyji.cz/_E_PODYJ.HTM)
Austri – Republika e Çekisë

Shpenzime të tërësishme:

2.797.904 euro

Kontribut i Bashkimit Evropian:

1.398.951 euro



9. Rrjeti i rrugëve të ngadalshme

Përmes krijimit të rrjetit të rrugëve me shpejtësi të kufizuar krijohen mundësi për rekreacion dhe turizëm, si dhe për përmirësimin e lëvizjes së banorëve lokal. Rrjeti i rrugëve të ngadalshme siguron mundësi për ecje në këmbë, vozitje të biçikletës, e në të ardhmen mundet edhe shëtitje me kuaj. Në këto rrugë është e ndaluar përdorimi i automjeteve motorike (automobila, motorë e tj.), me qëllim të garantimit të sigurisë dhe për të siguruar rekreacion dhe kënaqësi. Përveç kësaj, rrjeti i rrugëve me shpejtësi të kufizuar duhet ti nxisë njerëzit që ti vlerësojnë peizazhet, ti shmangen komunikacionit dhe ndotjes dhe të sigurojë mundësi të reja ekonomike.

Projekti kyçi partnerë nga gjashtë komuna, organizata për ruajtjen e natyrës, agjenci turistike dhe grupe lokale për aksion të cilat botuan një seri hartash për ecje në këmbë. Hartat e shfaqin rrjetin e rrugëve dhe bukuritë e spikatura të regjionit. Një pjesë e rezultateve ishte organizimi i udhëtimeve në këmbë, degustimi i specialiteteve lokale, restaurimi i rrugëve, vendosje të shenjave e tj.

Pa marrë parasysh që “rrugët e ngadalshme” shpesh herë janë afër truallit bujqësor, projekti synonte kah ajo që ti bind bujqit për vlerën shtesë të rrjetit. Përmes tërheqjes së vizitorëve në regjionin të cilët vijnë për shkak të rekreacionit, rrjeti siguroi mundësi të reja, siç është për shembull shitja e drejt-



përdrejtë e prodhimeve ose për turizëm bujqësor. Rrjeti, poashtu, e shtoi shitjen e tregtarëve ekzistues lokal, por priten edhe ta ardhura të rritura për hotelet, restorantet dhe kafeterinë. Pa marrë parasysh që qëllimi zanafillës ishte që të ruhen karakteristikat e rëndësishme të peizazheve regionale, ky projekt krijoi edhe mundësi për zhvillim të qëndrueshëm, që ishte edhe qëllimi përfundimtar i bashkësisë lokale.

Emri i organizatës:

Regionaal Landschap Zenne, Zuun & Zoniën
vzw

Kontakt personi:

An Rekkers

Adresa:

Donkerstraat 21

Kodi postar:

1750

Qyteti:

Gaasbeek

E-Mail:

info@rlzzz.be

Telefoni:

+3224526045

Faksi:

+3224600701

Internet adresa:

www.rlzzz.be

Buxheti i tërësishëm:

109.342 euro

Fondi garantues evropian për bujqësi:

48.110 euro

Financim publik kombëtar:

48.110 euro

Financim privat:

13.121 euro



10. Kardica e ndihmon zhvillimin rural

Nëse fluturoni mbi liqenin artificial Plastira në Greqinë qendrore mund të kënaqeni me peizazhin e shkëlqyer të rajonit Kardica, me kullotat e tija malore, përrënjtë, ekosistemet e shkëlqyera, përmendoret bizantine dhe fshatrat tradicionale. Vizitorët janë të admiruar nga bukuritë natyrore, nga mikpritja e banorëve dhe nga pasuria e traditave lokale.

Prapëseprapë, nuk është çdo gjë idilike në këtë rajon rural i cili ka pësuar disa rënie ekonomike dhe sociale në dekadat e kaluara. Ndikesa negative e ndërtimit të liqenit në pjesën e tokës më pjellore, qasja e keqe, numri jo i mjaftueshëm i spitaleve dhe i shkollave, si dhe mungesa e shërbimeve të ndryshme, nxitën

shumë njerëz të rinj të cilët nuk ishin të interesuar për bujqësinë që ta braktisin rajonin. Kjo shkaktoi rënie të popullatës dhe rritjen e moshës së saj.

Agjensioni për zhvillimin e Kardicës (AZhK), i cili i përfshin edhe Asociacionin e pushteteve lokale dhe Asociacionin e bujqve, u themelua në vitin 1989. Roli i saj është të koordinojë iniciativa dhe ti përmirësojë partneritetet dhe rrjetet për revitalizimin e regjionit. Me përvojën disavjeçare, AZhK ishte në gjendje ta udhëheq Lider programin nga viti 1996 deri në vitin 1999. Rajoni kishte 37.500 njerëz dhe përfshiu 13 komuna dhe 78 distrikte.

Qëllimi i programit ishte ndryshimi i trendit të rënies, me krijimin e aktiviteteve të realizueshme dhe të sigurohen të hyra plotësuese për bashkësinë rurale,



të përmirësohen kushtet jetësore dhe të inkurajohen njerëzit të mbeten të jetojnë në regjionin. Qasja e aplikuar ishte me qëllim të promovimit të zhvillimit të “integruar” të rajonit rural përmes të ashtuquajturës nga poshtë – lartë (bottom-up) masave inovative, përfshirë aty të gjithë partnerët, si dhe bashkësinë. Këto masa i mbuluan të gjitha lëmenjtë e aktiviteteve dhe e shfrytëzuar tërë vëllimin e resurseve lokale (njerëzore, natyrore, institucionale, kulturore dhe të tjerat), e në të njëjtën kohë theksi u vendos edhe në mbrojtjen e ambientit jetësor.

Filozofia themelore dhe prijëse ishin që dobësitë të transformohen në kapital dhe të vihet theksi në zbulimet dhe gjërat autentike. Promovimi i turizmit rural dhe formave tjera alternative të turizmit ishte lëmi me sukses të jashtëzakonshëm. Kjo, poashtu, kishte efekt nxitës dhe rezultoi me zhvillimin e aktiviteteve kom-

plementare në një numër të madh të sektorëve tjerë. E tërë kjo kontribuoi të zhvillohet ofrimi i shërbimeve të ndryshme nga ana e bashkësisë.

Disa nga rezultatet në të rëndësishme janë ndërtimi i 10 hoteleve me 180 shtretër, 5 qendra pushimi, 12 kompani zeytare (arte folklorike, farkëtarë, zdrukthetari, veshje të qepura te rrobaqepësit e tj.), 12 agrobiznese (përfshirë aty edhe përpunimin e mishit, prodhimet organike, buka dhe ushqimi për kafshët), dy qendra për ekspozita, 2 fidanishte për bimë, punishte për prerjen e drurëve dhe 2 pika karburanti.

Përfitime tjera ishin restaurimi i përmendoreve, udhëtime tematike, shpallje të ciceronëve dhe trajnime (600 orë teori dhe punë praktike për 48 vijues), në tema siç janë turizmi, bujqësia, kultivimi i kafshëve dhe ambienti jetësor. U hapën gjithsej 130 vende të



përhershme pune dhe 120 vende të kohë pas kohshme pune, dhe 90 vende pune u bënë më të sigurta. Suksesi i programit Lider te bashkësia lokale para së gjithash ka të bëjë me rolin e AZhK, i cili ishte i dizajnuar që të jetë strukturë fleksibile dhe transparente

që do të jetë e lidhur ngushtë me bashkësinë dhe nuk do të presë shirita të kuq. Përmes programit Lider, AZhK e nxiti frymën e ngritjes së iniciativave dhe i inkurajoi inovacionet lokale.



Projekti:

Leader II Karditsa

Kontakti:

Development Agency of Karditsa (AN.KA) SA
Allamani kai Blatsouka
GR-43100 Karditsa
c/o Mr Evaggelos Sakellariou

Telefoni:

(30) 24 41 04 23 63

Faksi:

(30) 24 41 07 16 36

E-mail:

anka@anka.gr

Internet:

<http://www.anka.gr>
Internet faqja e Këshillit të Qytetit:
<http://www.karditsa-net.gr/>

Shpenzime të tërësishme:

9.302.000 euro

Kontribut i Bashkimit Evropian:

4.825.000 euro

11. Ringjallje e zejeve të vjetra

Tirolli ka trashëgimi të pasur të mobilies nga periudha të ndryshme të kulturës. Kishte nevojë për zejtarë të specializuar për ta ruajtur dhe për ta restauruar në mënyrë përkatëse kjo trashëgimi e pasur. Projekti filloi me idenë të një drejtori të dedikuar të shkollës dhe marangozi që dëshironin ti gjallërojnë dhe ti vënë në dispozicion një grupi të njerëzve të interesuar përmes trajnimit të specializuar. Kjo ide u zhvillua në trajnim profesional me disa qëllime. Qëllime kryesore të programit ishin sigurimi i trajnimit për kualifikime më të larta dhe ndihmë për kompanitë e vogla të marangozëve në regjion që ato të zhvillojnë një lidhje të tregut të zejtarëve përmes kombinimit të traditave të vjetra me teknikat e reja. Organizatorë ishin tre shkollat profesioniste në pjesën veriore, lindore dhe jugore të Tirollit (Absam, Linc dhe Briksen), të cilat e bënë konceptin për këtë trajnim të specializuar me esnafin e marangozëve dhe ekspertë tjerë, e mandej ky program u përkrah nga iniciativa Interreg II. Poashtu, u organizuan edhe ekskursione deri te qendrat e rëndësishme lokale dhe ndërkombëtare, me qëllim të pasurimit të përmbajtjes dhe të teknologjisë së programit.



Kontakti:

Christof Spielberger
Amt der Tiroler Landesregierung/Abteilung JUFF
Michael-Gaismairstraße 1
A-6020 Innsbruck

Telefoni:

(43-512) 508 35 77

Faksi:

(43-512) 508 35 84

E-mail:

c.spielberger@tirol.gv.at

Internet:

www.tirol.gv.at/juff/arbeitnehmerfoerderung1.html

Shpenzime të tërësishme:

123.520 euro

Kontribut i Bashkimit Evropian (Interreg, ESF):

53.052 euro



12. Restaurimi i trashëgimisë urbane

E shtrirë në kufirin spanjoll-portugez, Valenca ka trashëgimi të pasur kulturore, e cila i reflekton ndërlidhjet e shumta midis lindjes së largët të Portugalisë dhe Galicisë. Me përkrahjen e FEZHR dhe programin operativ Norte regjion, autoritetet komunale filluan një sërë projektesh për restaurimin dhe rinovimin e qendrës historike të qytetit. Me përmirësimin e mjedisit urban dhe me modernizimin e strukturës themelore (sistemi i ujërave të zeza, rrugët e kështu me radhë), u punua në promovimin e turizmit kulturor dhe në ndaljen e rënies demografike, përmes krijimit të aktiviteteve dhe cilësisë më të mirë të jetës.

Kontakti:

Jorge Sobrado, CCDR-Norte

E-mail:

vitor.devesa@ccdr-n.pt

Shpenzime të tërësishme:

2.600.000 euro

Kontribut i Bashkimit Evropian:

1.900.000 euro



INSTRUMENTE FINANSIARE TË BE NË LËMIN E TURIZMIT

1. Fondet strukturore në periudhën e viteve 2000–2006

Fondet strukturore janë instrumentet kryesore për sigurimin e ndihmës për aktivitetet “strukturore” të Unionit, përkatësisht për aktivitetet e orientuara ndaj zvogëlimit të dallimeve sociale dhe ekonomike. Fondet strukturore janë komplementare me financimet kombëtare ose private dhe përdoren për implementimin e programeve të mëdha, të cilat mbulojnë një spektër të gjerë të aktiviteve lokale, regionale dhe kombëtare.

Ato i kombinojnë intervenimet e veta në pajtim me nevojat. Në periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2006 ishin operativ këto katër fonde:

1. **Fondi Evropian për Zhvillim regional (FE-ZhR)** – infrastruktura evropiane, investime për krijimin e vendeve të punës, projekte lokale zhvillimore dhe ndihmë për firma të vogla.

2. **Fondi Evropian social (FES)** – e promovoi kthyerjen e të papunëve dhe të gupeve të invalidëve në krahun e punës, kryesisht përmes financimit të trajnimeve dhe sistemeve për ndihmë rekrutim.
3. **Fondi Evropian garantuese i bujqësisë (FEGB)** – ky fond financoi masa për zhvillimin rural dhe sigurimin e ndihmës për bujqit, kryesisht në regionet të cilat ngecin me zhvillimin, dhe u përdor edhe për përkrahje të iniciativës Lider +.
4. **Instrumenti financiar për peshkatarin (INP)** – i ndihmoi industrisë së peshkatarisë të adaptohet dhe të modernizohet.

Qëllime për periudhën 2000–2006: Të përforcohet ndikesa e fondeve dhe të arrihen rezultatet më të mira të mundshme. 94% nga fondet strukturore për periudhën e viteve 2000–2006 ishin të përqendruara në 3 qëllime.

Qëllimi 1: Tu ndihmohet regjioneve të cilat ngecin, me qëllim që të zhvillohen dhe të arrijnë në nivel përafërsisht të njëjtë si dhe regjionet e zhvilluara. Rreth 50 regjione, në të cilat jetojnë 22% nga banorët e Unionit, ose rreth 83 milion banorë, hyjnë nën këtë qëllim dhe ata marrin 70% të mjeteve të qasshme. Në periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2006 me këtë masë ishin të përfshirë edhe 73 milion njerëz.

Qëllimi 2: Përkrahje e konversionit ekonomik dhe social në rajonet industriale, rurale, urbane ose peshkatarie të cilat ballafaqohen me vështirësi strukturore. Gjithsej 18% nga popullata në BE – 15, ose 68 milion njerëz, jetojnë në këto rajone, dhe ato pranuan 11,5% nga fondet e tërësishme.

Qëllimi 3: Modernizimi i sistemeve për trajnim dhe promovimin e punësimit. Masat e financuara nga qëllimi i tretë e mbulojnë tërë Unionin, përveç regjionet nga qëllimi i parë, ku masat për trajnim dhe punësim janë të kyçura në programet për barazimin e regjioneve. Ky qëllim fitoi 12,3% nga fondet e tërësishme.

Fondet strukturore në periudhën e viteve 2007–2013

Në këtë periudhë operative janë dy prej katër fondeve nga periudha e kaluar: Fondi Evropian për zhvillim regional dhe Fondi Evropian social.

1. Fondi Evropian për zhvillim regional (FEZrR)

FEZrR i përkrah programet për zhvillim regional, ndryshime ekonomike, konkurrencë të sforcuar dhe bashkëpunim territorial nëpër BE. Prioritetet në financimin kyçin hulumtime, inovacione, mbrojtje të ambientit jetësor dhe parandalim nga rreziqet, ndërsa investimet në infrastrukturën e mbajnë rolin e rëndësishëm, posaçërisht në regjionet më pak të zhvilluara

2. Fondi Evropian Social (FES)

FES fokusohet në katër lëmi kyçe: rritjen e përshtatshmërisë së punëtorëve dhe të ndërmarrjeve; përmirësimi i qasjes ndaj punësimit dhe pjesëmarrje në tregun e punës; përforcimi i inkluzionit social, përmes luftës kundër diskriminimit dhe lehtësimi i

qasjes së personave me invaliditet në tregun e punës dhe promovimi i partneritetit për reforma në lëmin e punësimit dhe të inkluzionit.

Qëllime për periudhën e viteve 2007–2013 v:

1. Konvergencë (paraprakisht qëllimi 1)

Ky qëllim i mbulon regjionet BPV i të cilëve është më i vogël se 75% nga mesatarja e BE dhe synon drejtë përshtetimit të aktiviteteve të tyre ekonomike. Prioritetet e këtij qëllimi janë kapitali njerëzor dhe fizik, inovacionet, shoqëria e diturisë, ambienti jetësor dhe efikasiteti administrativ.

2. Konkurrenca dhe punësimi regjional (paraprakisht qëllimi 2)

Ky qëllim i mbulon të gjitha regjionet në BE, përveç atyre që tanimë janë të mbuluara me qëllimin konvergjencë. Qëllimi është i orientuar drejtë përforsimit të konkurrencës, punësimit dhe atraktiviteti të këtyre regjioneve. Inovacioni, promovimi i sipërmarrësisë dhe mbrojtjes së ambientit jetësor janë temat kryesore të këtij qëllimi. Financat vijnë nga FEZHE dhe nga FES.

3. Bashkëpunimi territorial (paraprakisht qëllimi 3)

Ky qëllim synon drejtë përparimit të bashkëpunimit midis regjioneve evropiane dhe zhvillimin e zgjidhjeve të përbashkëta të problemeve në zhvillimin urban, rural dhe vendeve buzëdetare, të zhvillimit ekonomik dhe menaxhimin me ambientin jetësor.:

- bashkëpunim i tejkuftitar;
- bashkëpunim trans kombëtar, dhe
- bashkëpunim ndër regjional.

2. Fondi koheziv i viteve 2007–2013

Fondi koheziv është për shtetet-anëtare BPV i të cilëve është nën 90% nga mesatarja e BE. Ai kontribuon për intervenime në fushën e ambientit jetësor dhe rrjetet trans evropiane transportuese.

Fondi është i orientuar ndaj përforsimit të kohezionit ekonomik dhe social të Bashkimit, përmes financimit të projekteve, fazave teknikisht dhe financiarisht të pavarura të projekteve dhe grupe të projekteve të cilat formësojnë tërësi koherente, në lëmin e ambientit jetësor dhe rrjetet trans evropiane transportuese.

Fondi koheziv, poashtu kontribuon për studime fillestare në lidhje me projektet dhe implementimin e tyre, si dhe masa për ndihmë teknike siç janë: studimet komparative, studimet për efektin, studimet për monitorim, dhe që nga hyrja e tij në fuqi (1999) i përkrah edhe fushatat për publicitetet dhe fushatat informative.

Për momentin mjetet nga ai mund të marrin Greqia dhe Portugalia, si dhe shtet-anëtare të reja nga viti 2004 dhe nga viti 2007.

3. Fondi Evropian bujqësor për Zhvillim rural (FEBZHR) në periudhën 2007–2013

Ky instrument është i orientuar ndaj përforcimit të BE për zhvillim rural dhe thjeshtësimin e implementimit të tij. Ai e përmirëson menaxhimin dhe kontrollimin e politikës për zhvillim rural në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2013.

Fondi ndihmon në përmirësimin e temave të përmendura më lartë:

- **konkurrencë e bujqësisë dhe të pylltarisë;**
- **ambienti dhe rrethimi jetësor , dhe**
- **cilësia e jetës dhe menaxhimi me aktivitetet ekonomike në mjediset rurale.**

Çdo shtet-anëtar duhet të përpilojë plan për strategjinë kombëtare në pajtim me parimet strategjike të Unionit. Ky plan është për periudhën nga 1 janari i vitit 2007 deri më 31 dhjetor të vitit 2013 dhe implementimi i tij zhvillohet përmes programeve për zhvillim rural që përmbajnë pako masa të vendosura në grup prej 4 boshte. Boshti i tretë thotë: cilësia e jetës në mjediset rurale dhe diversifikimit i ekonomisë rurale. Në lidhje me diversifikimit e ekonomisë rurale, Rregullativa përmban masa për:

- **diversifikimit ndaj aktiviteve jo bujqësore, përkrahje e themelimit dhe zhvillimit të mikro bizneseve, promovimi i turizmit dhe në mbrojtje dhe zhvillim dhe menaxhim me trashëgiminë natyrore e cila kontribuon për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;**

- **përmirësimi cilësisë së jetës në rajonet rurale, me theks të posaçëm në renovimin dhe zhvillimin e fshatrave dhe ruajtje dhe përdorim të trashëgimisë rurale, dhe**
- **përfitimi i shkathësive dhe zbatimi i aktiviteteve me qëllim që të përgatitet dhe implementohet strategjia e zhvillimit lokal.**

4. SAPARD

Sapard është program special për bujqësi dhe zhvillim rural i cili ishte i krijuar për tu ndihmuar shteteve-kandidate nga Evropa Qendrore dhe Lindore për tu përgatitur për anëtarësi në Unionin (ndihmë paraqasëse). Kjo u realizua përmes dhënies së ndihmës për përshtatje të strukturave bujqësore dhe të zhvillimit rural. Fondi tërësisht ishte i decentralizuar dhe çdo vend-kandidat ishte përgjegjës për menaxhimin.

5. Iniciativa të Bashkësisë në vitet 2000–2006

Iniciativat e bashkësisë ishte program i orientuar ndaj asaj që ti plotësojë intervenimet e fondeve strukturore në lëmi të caktuara. Iniciativat e Bashkësisë absorbuan 5,35% nga buxheti i fondeve strukturore.

Në periudhën prej vitit 2000 deri në vitin 2006 u implementuar katër iniciativa të këtilla: Interreg, URBAN, Lider+, EQUAL

Në do ti përmendim ato që janë relevante për turizmin alternativ:

5.1 Interreg

Interreg është iniciativë e Bashkësisë e orientuar ndaj stimulimit të bashkëpunimit ndër regional në Bashkimin Evropian. Fillimet datojnë nga viti 1989, me financimin nga Fondi Evropian për zhvillim regional. Programi i tanishëm Interreg IV e mbulon periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2013.

Historia e Interreg sipas periudhave duket kështu:

në vitet 1989 – 1993 (Interreg I)

në vitet 1994 – 1999 (Interreg II)

në vitet 2000 – 2006 (Interreg III)

në vitet 2007 – 2013 (Interreg IV)

Qëllimi i programit: Interreg është i dizajnuar që ta stimulojë bashkëpunimin midis shteteve-anëtare të BE në nivele të ndryshme. Njëri nga qëllimet kryesore është zvogëlimi i ndikesës së kufijve kombëtare, për tu mundësuar zhvillimi i njëjtë ekonomik, social dhe kulturor në mbarë territorin e BE.

Qëllimi i Interreg është të përforcohet kohezioni ekonomik dhe social në BE përmes përparimit të bashkëpunimit tejkuftar, trans kombëtar dhe ndër regional dhe të zhvillimit të balancuar në territorin e BE. Aktivitetet në rajonet kufitare dhe pranë kufitare midis shteteve-anëtare të BE dhe shtetet që nuk janë anëtare, janë thelbi i kësaj iniciative.

Implementimi i iniciativës bëhet sipas 3 orientimeve:

a) bashkëpunim tejkuftar i cili promovon zhvillim të integruar regional midis regjioneve fqinje

kufitare, ndërsa qëllimi është zhvillimi i bashkëpunimit ekonomik dhe social përmes strategjive të bashkuara dhe programeve për zhvillim. Në lidhje me financat, në këtë drejtim shkon pjesa më e madhe;

- b) bashkëpunim trans kombëtar i cili ka për qëllim të promovohet shkallë më e lartë e integritimit përmes formimit të grupeve më të mëdha të regjioneve evropiane, për tu arritur zhvillim i qëndrueshëm, harmonik dhe i baraspeshuar në BE dhe integrim më i madh territorial, bashkë me vendet-kandidate dhe shtetet tjera fqinje;
- v) bashkëpunimi ndër regional në territorin e BE (dhe vendet fqinje) për tu përmirësuar efikasiteti i politikave për zhvillimin regional dhe instrumentet përmes këmbimit të një numri të madh të informacioneve dhe përmes bashkimit në rrjet. Në raport me financat, në këtë drejtim bie pjesa më e madhe, por programet i mbulojnë të gjitha shtetet-anëtare të BE.

Shfrytëzues përfundimtar të fondeve të Interreg janë pushtetet publike, asociacionet e interesuara dhe organizatat jo fitimprurëse, siç janë odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, sindikatat ose institucionet për hulumtime. Sipas Interreg IV, i cili realizohet vetëm përmes konzorciumit nga disa firma, gjë e cila nuk ishte e mundshme në periudhat paraprake programore.

5.2. LIDER+ në vitet 1991–2006

LIDER+ është njëra nga katër iniciativat e financuara nga fondet strukturore të BE dhe është e dizajnuar që tu ndihmojë banorëve të rajoneve rurale, duke e marrë parasysh potencialin afatgjatë të regjionit lokal.

Me inkurajimin e implementimit të strategjive të integruara, cilësore dhe origjinale për zhvillim të qëndrueshëm, posaçërisht theksohen partneritetet dhe rrjetet për këmbimin e përvojave.

Në fillim të zhvillimit, programi ishte i njohur si LIDER I (nga viti 1991 deri në vitin 1994). Ajo e shënoi fillimin e qasjes së re ndaj zhvillimit rural, të bazuar mbi parimin territorial, i cili do të jetë i integruar dhe participativ, ndërsa LIDER II (1994–1999)

e zgjeroi përfshirjen e programit të parë. Me vazhdimin, në kuadër të LIDER II përkrahet qasja rinovuese ndaj zhvillimit rural.

Perspektiva e fundit financiare në suazat e veta e kishte programin LIDER+ nga viti 2000 deri në vitin 2006, i cili e vazhdoi përkrahjen e qasjeve inovative për integrimin e zhvillimit të qëndrueshëm në politikën e zhvillimit rural.

Në pajtim me aktivitetet e parapara, LIDER+ financoi masa që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e drejtë të resurseve natyrore dhe kulturore, përmirësimin e cilësisë së jetës në mjediset rurale, përforcimin e vlerës së prodhimeve lokale dhe qasjen e prodhimeve të vogla në treg, si dhe përdorimi i teknologjive dhe diturive të reja për ta përmirësuar konkurrencën e prodhimeve në treg.





INSTRUMENTET FINANCIARE TË BE QË I QËNDROJNË NË PDISPOZICION MAQEDONISË

6.1. IPARD

Instrumenti për ndihmë paraqasëse (IPA) është i vendosur nga Këshilli i BE me miratimin e Rregullativës (BE) nr. 1085/2006 nga 17 korriku i vitit 2006.

Qëllimi i IPA është t'ju sigurojë ndihmë të orientuar vendeve-kandidate dhe kandidatëve potencial në harmonizimin e tyre progresiv me standardet dhe politikat e Unionit Evropian, si dhe me *acquis communautaire*.

Instrumenti për ndihmë paraqasëse (IPA) është i përbërë nga 5 komponentat vijuese:

- **Ndihmë në periudhën e tranzicionit dhe përsosjes institucionale;**
- **Bashkëpunimi tejkuftar;**
- **Zhvillimi regjional;**
- **Zhvillimi i resurseve njerëzore, dhe**
- **Zhvillimi rural.**

Republika e Maqedonisë, si vend-kandidat për anëtarësi në BE, ka qasje në të gjitha IPA komponentat. IPARD është komponenta e pestë nga IPA e dedikuar për zhvillimin rural.

Qëllimi kryesor i IPARD programit ka të bëjë me sa vijon:

“Të përmirësohet konkurrenca e ekonomisë bujqësore dhe të industrisë së ushqimit përmes zhvillimit, të harmonizohen me standardet e Bashkësisë, dhe sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekologjik dhe socio-ekonomik të rajoneve rurale përmes aktiviteteve të shtuara ekonomike dhe mundësive për punësim.”

Në programin janë përfshirë masat vijuese:

Prioritet 1: Përmirësimi i efikasitetit të tregut dhe implementimi i standardeve të Bashkësisë;

Masa 101: Investime në ekonomitë bujqësore për ta bërë ristrukturimin dhe të sendërtohen deri në standardet e Bashkësisë;

Masa 103: Investime në përpunimin dhe reklamimin e prodhimeve bujqësore që ato të ristrukturohen dhe të sendërtohen deri në standardet e Bashkësisë;

Prioritet 3: Zhvillimi i ekonomisë rurale;

Masa 302: Diversifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve rurale ekonomike.

Qëllimet e IPARD

Përfitimet themelore për Republikën e Maqedonisë nga realizimi i programit IPARD (2007 - 2013) janë:

- **Përmirësimi i efikasitetit të tregut dhe zbatimi i standardeve të Bashkimit Evropian përmes ristrukturimit dhe mbindërtimit të sektorit bujqësor – ushqimor deri në standardet e BE, si dhe përmes rritjes së konkurrencës që prodhimeve bujqësore dhe të atyre bujqësore – ushqimore me qëllim të përgatitjes së sektorit të bujqësisë për qasje drejt BE.**
- **Zhvillim i ekonomisë rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në mjediset rurale, me qëllim për të siguruar burime plotësuese të të hyrave për popullatën rurale dhe të hapen mundësi të reja për punësim në rajonet rurale.**

Mjete financiare nga IPARD

Korniza financiare për implementimin e IPARD programit e përbëjnë 75% nga mjetet e financuara nga buxheti i Bashkimit Evropian të dedikuara për ndihmë paraqasëse për zhvillim rural dhe 25% nga buxheti i republikës së Maqedonisë të dedikuara për programe zhvillimore. Shuma e tërësishme e mjeteve në dispozicion të dedikuara për programin IPARD është 60,7 milion euro, nga të cilat 45,5 milion euro janë nga buxheti i BE dhe 15,2 milion euro plotësuese nga buxheti i Republikës së Maqedonisë. Korniza financiare ka të bëjë me alokimet e bëra buxhetore për periudhën disa-

vjeçare buxhetore prej vitit 2007 deri në vitin 2011, me çrast mjetet akumulohen dhe shpenzohen në kornizë kohore prej 3 vitesh nga viti i alokimit të tyre. SHEMBULL: Mjetet financiare për vitin 2008, në lartësi të përgjithshme prej 8,8 milion euro, përfshirë aty edhe mjetet nga viti 2007, duhet të tërhiqen nga buxheti i Komisionit Evropian më vonë deri më datën 31.12.2011. Mjetet janë të dedikuara për dhënie përkrahjes financiare në formë të grantit në lartësi prej 50% nga shpenzimi i tërësishëm i realizuar i cili është në listën e shpenzimeve të pranueshme, për nga masat dhe investimet nga programi IPARD.

Cilat sektorë janë të përkrahur me këtë masë dhe me çfarë kushte?

Mikro ndërmarrje rurale:

- Vendorsja e kapaciteteve për përpunim në dhe jashtë fermës (për pemë, perime, mjaltë, vaj medicinal / bimë dhe mëlmesa, kërpudha):
 - Konstruksion / modernizim në ndërtime;
 - Pajisje për paketim, kapacitete për vendorsje në depo dhe pajisje tjetër;
 - Përpunim i prodhimeve ushqimore me dedikim, duke përdorur resurse nga fa5rma ose material të pa përpunuar nga prodhuesit lokal (me minimum kontratë njëvjeçare për furnizime);
 - Madhësia e kapaciteteve të nevojshme: për prodhimin e pemëve dhe të perimeve – minimum 0,5ha plantacion të vet; për prodhimin e prodhimeve të qumështit – minimum 10

krerë lopë qumështi, 150 dhen ose 50 dhi; për prodhimin e mjaltës – minimum 30 koshere bletësh; për prodhimin e vajit medicinal/bimë dhe mëlmesa në pajtim me listën zyrtare - 0,75ha, dhe për prodhimin e kërpudhave - 30m²;

- Vendorsja e qendrave për grumbullimin e kërpudhave dhe për vaj medicinal/bimë;
- Konstruksion/modernizim i ndërtimeve;
- Blerje e pajisjes;
- Aplikues mund të jenë vetëm kooperativa bujqësore të cilat patjetër duhet të kenë licencë për grumbullimin e kërpudhave të egra, bimë shëruese/aromatike dhe mëlmesa dhe prodhime kokrrizë.
- Konstruktimi / modernizimi i kapaciteteve për kultivimin e kërpudhave, përfshirë edhe prodhimin e kompostit.
- Vendorsje e punëtorive për zeje tradicionale:
 - Konstruktim / modernizim i ndërtimeve;
 - Blerje e pajisjes për paketim;
 - Aktivitete për marketing;
 - Vendorsje e pikave të shitjes;
 - Vendorsje e punëtorive për ndreqje.

Turizëm rural:

- **Rikonstruim / konversion i shtëpive të fermave për aktivitete turistike, përfshirë aty edhe për objekte për rekreacion:**

- **Renovim dhe adaptim i shtëpive në fermat për kapacitete për vendosje (maksimum 20 shtretër);**
- **Vendosje të serviseve për katering, për të provuar dhe vende shitjeje;**
- **Vendosje e muzeve rurale;**
- **Në raste të rikonstruktimit të bodrumeve të verës, aplikuesit patjetër duhet të kenë prodhimtari vjetore të verës prej minimum 20 deri 400 hl;**
- Nëse ndërtimi gjendet në rajon të mbrojtur kulturor ose është i vendosur në zonë të mbrojtur, aplikuesit patjetër duhet ta harmonizojë ndërtimin e standardet relevante kombëtare;
- Investimet në kapacitetet për rekreacion patjetër duhet të jenë të bashkangjitura me kapacitete për vendosje.

Nga lëmi i turizmit alternativ për Republikën e Maqedonisë posaçërisht interesante është masa 302:

Masa 302 – Diversifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve rurale ekonomike

Investimet e orientuara kah themelimi i mikro ndërmarrjeve dhe rikonstruim i ndërtimeve në dhe jashtë nga ekonomia bujqësore për qëllimet e turizmit fshatar duhet të kontribuojnë drejtë rritjes së shkallës së konkurrimit dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës dhe krijimit të mundësive për punësim, e me këtë rast duhet të vlerësohen dhe pikëpamjet tradicionale për bashkësitë rurale.

1. Sektore prioritare

Projektet investuese janë të orientuara drejtë krijimit dhe zhvillimit të mikro ndërmarrjeve, zhvillimit të zejtarisë dhe turizmit rural, me promovimin e sipërmarrësisë dhe me zhvillimin e strukturës ekonomike.

302. 1 Përkrahje e mikro ndërmarrjeve në rajonet rurale

302. 2 Promovimi i aktiviteteve nga turizmi fshatar

302.1.1 Investimet për vendosjen e kapaciteteve përpunuese në ekonominë bujqësore dhe në ekonominë jashtë bujqësore.

302.1.1 Investimet për vendosjen e kapaciteteve përpunuese në ekonominë bujqësore dhe në ekonominë jashtë bujqësore.

302.1.2 Investimet për vendosjen dhe modernizimin e qendrave blerëse për kërpudha dhe bimë shëruese/aromatike dhe mëlmesa dhe kapacitetet për kultivimin e kërpudhave.

302.1.3 Investimet për vendosjen e punëtorive për aktivitete tradicionale zejtare dhe punëtori për mirëmbajtje të mekanizimit bujqësor.

302. 2 Grup investimesh për promovimin e aktiviteteve në sferën e turizmit rural

302.2.1 Investime për rikonstruktimin e objekteve të ekonomisë bujqësore me dedikim për turizëm rural, e plotësuar me kapacitete për rekreacion.

302.2.2 Investime për ndërtimin e objekteve hote-lierike, vendosje nën qiell të hapur (vende për kamp) dhe kapacitete për rekreacion

Shpenzime të pranueshme për bashkë financimin e investimeve për hapjen e punëtorive për aktivitete tradicionale zejtare dhe punëtori për mirëmbajtjen e mekanizimit bujqësor janë shpenzime investuese për blerjen e:

- materiale për ndërtim dhe elemente për konstrukcion për ndërtim të objekteve të reja ose për përmirësimin e atyre ekzistuese; për instalimin e pajisjes për aktivitetet tradicionale zejtare, të vendosura në Listën e veprimtarive tradicionale zejtare, dhe kapacitetet përcjellëse për paketim dhe depozitim të prodhimeve; për ndërtim të objekteve të reja ose për përmirësimin e objekteve ekzistuese; për hapjen e punëtorive për mirëmbajtje të mekanizimit bujqësor, përfshirë edhe kapacitetet përcjellëse për depozitim dhe pajisjes dhe të veglave; hapësirë-parkimi dhe strehë;
- pajisje për ujësjellës dhe energji elektrike; sisteme për ngrohje dhe ventilim dhe sisteme kanalizimi; - pajisje dhe vegla për prerje dhe gdhendje të drurit;
- pajisje dhe vegla për drugdhendje;

- pajisje dhe vegla për tjerje të leshit;
- pajisje dhe vegla për ngjyrosje të leshit;
- pajisje dhe vegla për prodhimin e prodhimeve nga druri;
- pajisje dhe vegla për bërjen e qilimave dhe mbulesave nga leshi, materiale nga leshi ose prodhime tjera nga leshi;
- pajisje dhe vegla për shalë kali;
- pajisje dhe vegla për thurje;
- pajisje dhe vegla për qëndisje;
- pajisje dhe vegla për qepje dhe prerje;
- pajisje dhe vegla për prodhimin dhe përpunimin e filcit – leshit të pa tjerë;
- pajisje dhe vegla për farkëtarë;
- pajisje dhe vegla për prodhimin e prodhimeve nga te teneqeja;
- pajisje dhe vegla për përgatitje të lëkurës dhe prodhimin të prodhimeve nga lëkura;
- pajisje dhe vegla për prodhimin dhe dekorimin e poçarisë dhe qeramikës;
- pajisje dhe vegla për prodhimin e prodhimeve nga dylli;
- pajisje dhe vegla për përpunimin e litarëve;
- pajisje dhe vegla për thëngjillore (prodhimi i thëngjillit);
- pajisje dhe vegla për prodhimin e prodhimeve nga qelqi;

- pajisje dhe vegla për prodhimin e prodhimeve nga metali;
- pajisje për paketim dhe vënie të etiketave;
- pajisje për vendosje në depo;
- pajisje dhe vegla për rregullim të mekanizimit bujqësor;
- pajisje kompjuterike dhe softuer kompjuterik për kontroll të sistemeve për ngrohje dhe ventilim, paketim, vënie të etiketave, ndreqje të mekanizimit bujqësor;
- shpenzime për punë të kryera nga persona të tretë, si punë ndërtimore, përfshirë aty ndërtimin dhe pastrimin e terrenit për ndërtim, përgatitje e të terrenit për ndërtim dhe vendosjen e elementeve për konstruksion dhe materialet për ndërtim, instalimin e pajisjes për rrjet të ujësjellësit dhe energji elektrike, sisteme për ngrohje dhe ventilim, sistem kanalizimi, instalim i pajisjes për pranim, instalim të pajisjes kompjuterike dhe të softuerit kompjuterik për kontroll të sistemeve për ngrohje dhe ventilim, paketim, vënie të etiketave, ndreqje të mekanizimit bujqësor;
- shpenzime plotësuese të përgjithshme për punimin e fizibiliteti-studimeve, projekteve teknike dhe studime tjera të ndërlidhura me projektin, shërbime konsultuese, ndihmë teknike dhe mbikëqyrje të vazhdedës së zbatimit të projektit, të siguruar nga ekspertë të autorizuar, si dhe shpenzime për të drejtat nga patentat dhe licencat.

Promovimi i aktiviteteve nga turizmi fshatar

Projektet e pranueshme për promovimin e aktiviteteve të turizmit fshatar duhet të orientohen drejtë një ose më tepër nga qëllimet vijuese:

- **rikonstruim dhe ridedikim i objekteve të ekonomisë bujqësore për turizëm rural, si dhe për kapacitete për rekreacion;**
- **ndërtim i objekteve hotelierike, kapaciteteve për vendosje nën qiell të hapur (vende kampi) dhe kapacitete për rekreacion.**

Shpenzime të pranueshme për bashkë financim të investimeve për rikonstruimin e objekteve të ekonomisë bujqësore me dedikim për turizëm rural, të plotësuara me kapacitete rekreative janë shpenzime investuese për blerje të:

- **materiale për ndërtim dhe elemente për konstruksion për përmirësimin e objekteve ekzistuese për sigurimin e kushteve për vendosje, hotelieri, degustim, shitje, muze rural, përmirësim të regjimeve sanitare –higjienike, përfshirë aty edhe kapacitetet përcjellëse dhe sigurimi i qasjes së lirë për personat e hendikepuar, vend për piknik, kushte të posaçme sanitare, sigurimi i kapaciteteve për rekreacion (pishina për larje, terrene sportive – të hapura dhe të mbyllura, kalërim, çiklizëm, peshkim, terrene për lojëra të fëmijëve);**
- **pajisje për ujësjellës dhe energji elektrike, sisteme për ngrohje dhe ventilim, sistem kanalizimi, shërbime të telekomunikimit dhe të internetit;**
- **pajisje për trajtimin e ujit dhe stacione pastrimi për ujë në ekonominë bujqësore ose jashtë**

- nga ekonomia bujqësore e dedikuar për këtë aktivitet specifik;
- pajisje për kapacitete për vendosje, përfshirë edhe prodhime të drurit, mbulesa dyshem-eje, nyje sanitare (me përjashtim të shtojcave dekorative, shtresa për krevate, peshqirë);
- pajisje për hotelieri dhe kuzhina përfshirë aty edhe pajisjet (me përjashtim të sendeve për amvisëri dhe rezervat për hotelieri), mobile trapezari (me përjashtim të shtojcave dekorative);
- pajisje për sigurimin e kapaciteteve për rekrucion – pishinë për larje, terrene sportive, stallë për kuaj, terrene për kalërim, çiklizëm, fusha lojërash, platforma për peshkim e tj.;
- pajisje për kalërim;
- pajisje për mundësimin e qasjes së lirë për personat e hendikepuar jashtë dhe brenda në objektet (përfshirë aty edhe elevatorë dhe ashensorë) dhe kushte speciale sanitare;
- pajisje për kënaqjen e standardeve sanitare dhe higjienike;
- televizorë, risiverë satelitor, radio dhe audio pajisje;
- pajisje kompjuterike dhe softuer kompjuterik për menaxhimin administrativ me turizmin rural;
- shpenzime për punë të bëra nga persona të tretë si punë ndërtimore përfshirë rrënimin dhe pastrimin e terrenit për ndërtim, përgatitje e terrenit për ndërtim dhe vendosje e elementeve për konstruksion dhe të materialeve për ndërtim, instalimi i pajisjes për ujësjellës dhe rrymë elektrike, për sisteme për ngrohje dhe ventilim, sistem kanalizimi, pajisje për telekomunikim dhe internet, instalim për pajisje pranimi , instalim i pajisjes kompjuterike dhe i softuerit kompjuterik për menaxhimin administrativ me turizmin rural;
- shpenzime plotësuese të përgjithshme për përpunimin e fizibiliteti-studimeve, projekte teknike dhe studime tjera të ndërlydhura me projektin, të siguruara nga ekspertë të autorizuar, si dhe shpenzime për të drejtat nga patentat dhe licencat.

PËR MË TEPËR INFORMACIONE PËR MUNDËSITË QË I OFROJNË FONDET

Ministria e bujqësisë,
pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave

Trupi për menaxhimin me IPARD

rr. “Bellastica” nr. 2, 1000 Shkup

Telefoni: 02/3110-887; 3109-809

Faksi: 02 3110-887

www.mzsv.gov.mk

Agjensioni për përkrahjen financiare
në bujqësinë dhe zhvillimin rural

rr. “Skupi” nr. 3a, 1000 Shkup

Telefoni: 02/ 3097-450

Faksi: 02 3097-454

e-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

www.ipardpa.gov.mk

6.2 IPA BASHKËPUNIMI TEJKUFITAR

IPA bashkëpunimi tejkufitar në vitet 2009–2011

Ndihma për bashkëpunim tejkufitar sipas Komponentës II nga IPA është e orientuar drejtë përparimit të raporteve të mira midis regjioneve dhe shteteve. Kjo ndihmë do të fokusohet kryesisht në krijimin e lidhjeve midis regjioneve pranë kufitare, përkrahjen e aktiviteteve të përbashkëta për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe përmirësimin e potencialit për turizëm.

Regjionet të cilat mund të aplikojnë nga të dyja anët e kufijve sipas ndarjes së regjioneve (të ashtuquajturat NUTS regjione) janë me sa vijon:

1. Bashkëpunimi tejkufitar midis Maqedonisë dhe Bullgarisë:
 - Maqedoni – Regjioni Veriperëndimor, Lindor dhe Juglindor
 - Bullgari – Qustendill, Bllagoevgrad
2. Bashkëpunimi tejkufitar midis Maqedonisë dhe Greqisë:
 - Maqedoni – Regjioni Juglindor, regjioni i Vardarit, Pellagonija
 - Greqia – Palla, Seres, Fllorina, Kukush
3. Bashkëpunimi tejkufitar midis Maqedonisë dhe Shqipërisë:
 - Maqedonia – Pellagonija, regjioni Jugperëndimor, Pollogu
 - Shqipëria – Korça, Dibra, Elbasani

Prioritete dhe qëllime kryesore

Programet tejkufitare janë të orientuara drejtë dhënies së kontributit të tyre për zhvillimin e qëndrueshëm, stabilitetin dhe prosperitetin e rajoneve kufitare për interesin e përbashkët të banorëve dhe institucioneve në të dy shtetet. Shtetet-pjesëmarrëse i kanë kontraktuar qëllimet vijuese:

Bashkëpunimi tejkufitar me Bullgarinë

- të vazhdohen lidhjet ekzistuese ose të krijohen lidhje të reja midis administratave lokale/regionale, asociacioneve, organizatave joqeveritare ose ndërmarrjeve, të përforcohet zhvillimi ekonomik dhe social të rajoneve pranë kufitare;
- të përmirësohet infrastruktura turistike dhe transportuese me qëllim të rritjes së potencialit për zhvillimin e turizmit, si dhe të kontribuohet për mbrojtjen e ambientit jetësor;
- të intensifikohen kontaktet në nivel lokal midis banorëve të cilët jetojnë në dhe jashtë BE, dhe
- të ndihmohet me implementimi e programit dhe të kontribuohet për realizimin në kohë të rezultateve.

Bashkëpunimi tejkufitar me Greqinë

- të zvogëlohet dallimi në zhvillimin ekonomik midis rajoneve pranë kufitare dhe pjesët tjera të shtetit me ndihmë për tu krijuar vende të reja të punës, si rezultat i bashkëpunimit midis pjesëmarrësve ekonomik;

- të përforcohet potenciali për turizëm të regjion-it pranë kufitar dhe të rritet numri i vizitorëve të huaj, si dhe të përforcohet shëndetësia publike përmes aktiviteteve tejkufitare;
- të promovohen aktivitete të përbashkëta për mbrojtjen e ambientit natyror dhe kulturor;
- të intensifikohen kontaktet në nivel lokal dhe regional midis banorëve të cilët jetojnë në dhe jashtë BE, dhe
- të ndihmohet në implementimin e programit dhe të kontribuohet për dërgimin në kohë të rezultateve.

Bashkëpunimi tejkufitar me Shqipërinë

- të përkrahet zhvillimi ekonomik me theks të posaçëm mbi turizmin: aktivitete të zgjatura turistike, lloje alternative të turizmit dhe zhvil-

limi i infrastrukturës së vogël;

- të promovohet zhvillimi i qëndrueshëm me theks të veçantë në mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin me resurset njerëzore dhe ekosistemet: vendosje e politikave të përbashkëta për ambientin jetësor; kyçje e shoqërisë civile në miratimin e politikave; garantimi i menaxhimit të qëndrueshëm me resurset natyrore;
- të intensifikohet këmbimi kulturor përmes aktiviteteve “nga njerëzit për njerëzit” dhe “nga institucioni për institucionin”, dhe
- të ndihmohet në implementimin e programit dhe të kontribuohet për dërgimin në kohë të rezultateve.

Indikatorë financiar

Sipas Komponentës II, radhitja për shfrytëzimin e mjeteve është sipas pasqyrimin në tabelën

Programi	Shqipëria	Bullgaria	Greqia
Zhvillim ekonomik	90%	40% - 60%	30% - 50%
Turizëm/ Infrastrukturë		30% - 50%	20% - 40%
Ndërtimi i rrjeteve tejkufitare		10% - 20%	10% - 20%
Ndihmë teknike	Maksimum 10%	Maksimum 10%	Maksimum 10%

Në raport me programet për bashkëpunim tejkufitar me Serbinë dhe Kosovën, shtetet-shfrytëzuese, bashkë me Komisionin Evropian, do të vendosin se kur do të fillojë procesi i programimit dhe si do të duket alokimi i mjeteve.

